

Urime për telefonin tuaj Sony Ericsson T700. Komunikoni me elegancë. Tregojeni veten.

Në selinë [www.sonyericsson.com/fun](http://www.sonyericsson.com/fun) do të gjeni materiale të mëtejshme për telefonin.

Regjistrohuni tani në [www.sonyericsson.com/myphone](http://www.sonyericsson.com/myphone) për të marrë një suitë veglash, vend arkivimi gratis në linjë, oferta speciale, lajme dhe njoftime për konkurse.

Për asistencë teknike në lidhje me produktin, shkoni te [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support).

## Pajisje shtesë – Shtojani funksionalitetin telefonit

### Kufje Bluetooth™ HBH-PV720

Kufje pa tel e sofistikuara, për ata që i kushtojnë kujdes modës.



### Paketë energjie Power Pack CPP-100

Energji rezervë, kur t'ju mbarojë bateria



### Këllëf gjimnastikor IDC-32

Mbajeni telefonin të mbrojtur, kur jeni duke bërë ushtrime



Këto pajisje mund të blihen veçmas, por mund të mos gjenden në të gjitha tregjet. Për të parë një listë të plotë produktesh shkoni te [www.sonyericsson.com/accessories](http://www.sonyericsson.com/accessories).

**This is the Internet version of the User guide. © Print only for private use.**

# Përmbajtja e lëndës

## **Për të filluar ..... 6**

Montimi .....	6
Për ta ndezur telefonin .....	7
Ndihma .....	8
Për të ngarkuar baterinë .....	9
Vështrim i përgjithshëm mbi telefonin .....	10
Pamje e përgjithshme e menuve .....	12
Lundrimi .....	14
Kujtesa .....	15
Gjuha në telefon .....	16
Për të futur tekst .....	17

## **Muzika ..... 18**

Sistemi stereo portativ pa duar ....	18
Riprodhuesi muzikor .....	19
PlayNow™ .....	20
TrackID™ .....	20
Muzika dhe videoklipet në Internet ....	21
Riprodhuesi video .....	21
Radio .....	21
MusicDJ™ .....	22
Regjistrimi zanor .....	22

## **Transferimi dhe trajtimi i materialeve ..... 23**

Trajtimi i materialeve në telefon ....	23
--	----

Për t'i dërguar materiale një telefoni tjetër .....	23
Për të shkëmbyer materiale me një kompjuter .....	24
Përdorimi i kabllos USB .....	25
Emri i telefonit .....	26
Përdorimi i radioteknologjisë Bluetooth™ .....	26
Arkivimi dhe rikthimi .....	27

## **Telefonimi ..... 29**

Për të bërë dhe marrë telefonata ...	29
Kontaktet .....	31
Lista e telefonatave .....	35
Telefonimi i shpejtë .....	35
Posta zanore .....	35
Komandimi zanor .....	36
Disa telefonata njëkohësisht .....	37
Bllokimi i telefonimit .....	39
Kohëzgjatja dhe kostoja e telefonatave .....	40
Për ta treguar ose fshehur numrin tuaj .....	40

## **Mesazhimi ..... 41**

Mesazhet shkrimore .....	41
Mesazhet-figurë .....	42
Mundësitë shtesë të mesazheve ...	42

Modelet .....	43
Mesazhet zanore .....	43
Posta elektronike .....	44
Shokët e mi .....	45
Informacioni zonal dhe celular .....	47

## **Trajtimi i imazhit ..... 47**

Tastet e pamorit dhe të kameras ...	47
Si përdoret kamera .....	47
Funksione të tjera të kameras .....	48
Për të parë dhe etiketuar fotot .....	49
Blogimi .....	51
Printimi i fotove .....	52

## **Interneti ..... 52**

Kujtesoret .....	52
Faqet që keni shfletuar .....	53
Funksione të tjera të shfletuesit .....	53
Sigurshmëria në Internet dhe certifikatat .....	54
Burimet në Internet .....	54

## **Sinkronizimi ..... 56**

Sinkronizimi me anë të një kompjuteri .....	56
Sinkronizimi nëpërmjet një shërbimi në Internet .....	57

## **Tipare të tjera ..... 59**

Profili avion .....	59
Shërbimi përditësues .....	59

Shërbimet e vendndodhjes .....	60
Alarmet .....	60
Kalendari .....	62
Shënimet .....	63
Detyrat .....	63
Profilet .....	64
Ora dhe data .....	64
Tema .....	64
Pamja e menisë kryesore .....	65
Tonet e ziles .....	65
Orientimi i ekranit .....	65
Lojërat .....	65
Aplikacionet .....	66
Kyçet .....	66

## **Mënjanimi i problemeve ..... 69**

Pyetje që bëhen shpesh .....	69
Mesazhet e gabimit .....	72

## **Të dhëna të rëndësishme ..... 73**

Udhëzime për përdorim të sigurt dhe të frytshëm .....	75
Garancia e kufizuar .....	79
FCC Statement .....	82
Declaration of Conformity for T700 .....	83

## **Treguesi alfabetik ..... 84**

## Sony Ericsson T700

UMTS HSDPA 2100 GSM EDGE 850/900/1800/1900

Ky Udhëzues përdorimi botohet nga Sony Ericsson Mobile Communications AB ose nga filialia e saj lokale, pa ndonjë garanci. Sony Ericsson Mobile Communications AB mund t'i bëjë përmirësimet ose ndryshime këtij udhëzuesi përdorimi, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, për shkak gabimesh shtypi, pasaktësish në informacionin e paraqitur ose përmirësimesh në programe dhe/ose pajisje. Ndryshime të tilla, në çdo rast, do të pasqyrohen në botimet e reja të këtij udhëzuesi.

Të gjitha të drejtat të rezervuara.

©Sony Ericsson Mobile Communications AB, 2008  
Botim numër: 1215-9391.1

Vini re:

Disa nga shërbimet e përshkruara në këtë Udhëzues përdorimi nuk përballohen nga të gjitha rrejet. *Kjo vlen edhe për numrin ndërkombëtar GSM të urgjencës 112.*

Lidhuni me operatorin e rrejtit ose ofruesin e shërbimit po të mos jeni të sigurt nëse mund ta përdorni apo jo një shërbim të caktuar.

Lutemi lexoni kapitujt *Të dhëna të rëndësishme* para se të filloni ta përdorni telefonin tuaj celular. Telefonit juaj është në gjendje të shkarkojë, ruajë dhe t'u përcjellë të tjerëve materiale të ndryshme, p.sh. tone zëlesh. Përdorimi i materialeve të tilla mund të kufizohet ose ndalohet për shkak të së drejtave të palëve të treta, duke përfshirë kufizimet parashikuar në ligjet e aplikueshme për mbrojtjen e të drejtave të autorit, por pa u kufizuar me to. Ju, jo Sony Ericsson, mbani përgjegjësi të plotë për materiale shtesë që shkarkoni në telefonin tuaj celular, ose u përcillni të tjerëve nga telefoni juaj. Para se të përdorni një material shtesë çfarëdo, sigurohuni se përdorimi që keni në mend është i licensuar ose përndryshe i autorizuar. Sony Ericsson nuk garanton saktësinë, integritetin ose cilësinë e materialeve shtesë ose çdo lloj

materiali tjetër me prejardhje nga palë të treta. Në asnjë rrethanë nuk mund t'i lihet Sony Ericsson përgjegjësia për përdorim të papërshtatshëm, nga ana juaj, të materialeve shtesë ose materialeve të tjera me prejardhje nga palë të treta.

Smart-Fit Rendering është markë tregtare ose markë e regjistruar e ACCESS Co., Ltd.

Bluetooth është markë tregtare ose markë e regjistruar e Bluetooth SIG Inc. dhe çdo përdorim i një marke të tillë nga Sony Ericsson është i licensuar.

Logoja Liquid Identity logo, Sens Me, PlayNow, MusicDJ, PhotoDJ, TrackID dhe VideoDJ janë marka tregtare ose marka të regjistruara të Sony Ericsson Mobile Communications AB. TrackID™ fuqizohet nga Gracenote Mobile MusicID™. Gracenote dhe Gracenote Mobile MusicID janë marka tregtare ose marka të regjistruara të Gracenote, Inc.

Lotus Notes është markë tregtare, ose markë e regjistruar e International Business Machines Corporation.

Sony, Memory Stick Micro™ dhe M2™ janë marka tregtare ose marka të regjistruara të Sony Corporation.

Google™ dhe Google Maps™ janë marka tregtare ose marka të regjistruara të Google, Inc.

SyncML është markë tregtare ose markë e regjistruar e Open Mobile Alliance LTD.

Ericsson është markë tregtare ose markë e regjistruar e Telefonaktiebolaget LM Ericsson.

Adobe Photoshop Album Starter Edition është markë tregtare ose markë e regjistruar e Adobe Systems Incorporated në SHBA dhe/ose në vende të tjera.

Microsoft, ActiveSync, Windows, Outlook dhe Vista janë marka tregtare ose marka të regjistruara të Microsoft Corporation në SHBA dhe/ose në vende të tjera.

T9™ Text Input është markë tregtare ose markë e regjistruar e Tegic Communications. T9™ Text Input është e licensuar nga një nga patentat e mëposhtme: Patentat amerikane no. 5,818,437, 5,953,541, 5,187,480, 5,945,928, dhe 6,011,554; patenta kanadeze no. 1,331,057, patenta britanike no. 2238414B; patenta standard e Hong Kongut no. HK0940329; patenta e Republikës së Singaporit no. 51383; patenta evropiane no. 0 842 463(96927260.8) DE/DK, FI, FR, IT, NL, PT, ES, SE, GB; dhe patenta të tjera në miratim e sipër në mbarë botën.

Ky produkt mbrohet nga disa të drejta të pronësisë intelektuale të Microsoft. Përdorimi ose shpërndarja e teknologjive të tilla jashtë këtij produkti janë të ndaluara, pa licensën përkatëse nga Microsoft. Për të mbrojtur pronat e tyre intelektuale, duke përfshirë edhe të drejtat e autorit, pronarët e materialeve përdorin teknologjinë e administrimit të të drejtave numerike të Windows Media (WMDRM, ose Windows Media Digital Rights Management, në anglishte). Kjo pajisje përdor programe WMDRM për të trajtuar materiale të mbrojtura me WMDRM. Në qoftë se programet WMDRM nuk arrijnë t'i mbrojnë materialet, pronarët e materialeve mund t'i kërkojnë Microsoft-it që t'u revokojë programeve aftësinë për të përdorur WMDRM, për të riprodhuar ose kopjuar materiale të mbrojtura. Revokimi nuk do të prekë materialet e pambrojtura. Kur shkarkoni licensa për materiale të mbrojtura, ju njëkohësisht jepni pëlqimin tuaj që Microsoft-i t'i shoqërojë licensat me një listë revokimi. Pronarët e materialeve mund t'ju kërkojnë që ta gradoni teknologjinë WMDRM, për të qenë në gjendje të përdorni materialet. Nëse vendosni të mos e kryeni gradimin, nuk do t'i përdorni dot materialet për të cilat duhej kryer gradimi.

Ky produkt licensohet në bazë të portofolit të patentave pamore MPEG-4 dhe patentave AVC për përdorim personal dhe jokomercial të një konsumatori për (i) kodim videosh në pajtim me standardin pamor MPEG-4 («video MPEG-4») ose


standardin AVC («video AVC») dhe/ose (ii) dekodim videosh të formatit MPEG-4 ose AVC të koduara nga një konsumator i përfshirë në veprimtari personale jokomerciale dhe/ose siguruar nga një ofruer materialesh video i licensuar nga MPEG LA për të ofruar video MPEG-4 dhe/ose AVC. Asnjë licensë tjetër nuk jepet, as nënkuptohet, për çfarëdo përdorimi. Të dhëna të mëtejshme, duke përfshirë të dhëna për përdorime promovionale, të brendshme dhe komerciale si dhe licensimin përkatës, mund të merren nga MPEG LA, L.L.C. Shihni <http://www.mpegla.com>. Teknologjia e kodueses MPEG Layer-3 është licensuar nga Fraunhofer IIS dhe Thomson.

Java, JavaScript dhe të gjitha markat tregtare të mbështetura në Java janë marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara të Sun Microsystems, Inc. në SHBA dhe në vende të tjera. Marrëveshje me përdoruesin për platformën Sun Java, Micro Edition. 1. Kufizimet: Programet përfaqësojnë informacion të fshehtë dhe të mbrojtur me të drejta autori të Sun, e cila korporatë dhe/ose licensuesit e saj zotërojnë të drejtat mbi të gjitha kopjet. Klienti nuk do të modifikojë, shkoplojë, shpërbëjë, dekrptojë, përxjerrë ose përndryshe kundërxhinierojë Programet. Programet nuk mund të jepen me qera, për përdorim ose të nënlicensohen, në tërësinë e tyre ose pjesërisht. 2. Rregulla për eksportim: Programet, duke përfshirë të dhëna teknike, u nënshtrohen ligjeve amerikane të kontrollit të eksporteve, duke përfshirë këtu Ligjin Administrativ të Eksporteve Amerikane U.S. Export Administration Act dhe rregulloret që i bashkëlidhen; gjithashtu mund t'u nënshtrohen rregullave për eksportim dhe importim në vende të tjera. Klienti pranon t'u përbahet me repretis rregulloretve të tilla si dhe merr mbi vete përgjegjësinë për të siguruar licensa, nëse dëshiron të eksportojë, riekportojë ose importojë Programe. Programet nuk mund të shkarkohen, as të eksportohen ose të riekportoohen me mënyra të tjera (i) drejt një shtetasi ose banori në Kubë, Irak, Iran, Kore e Veriut, Libi, Sudan, Siri

(kjo listë mund të rishikohet herë pas here) ose çdo vendi tjetër ndaj të cilit SHBA ka vendosur embargo mallrash; ose (ii) drejt kujtdo që gjendet në listën e Departamentit të Thesarit të SHBA të Vendeve me Cilësim të Posaçëm (Specially Designated Nations) ose në tabelën e Refuzimit të Porosive të Departamentit të Tregtisë të SHBA. 3. Të drejta të kufizuara: Përdorimi, shumëfishimi ose divulgimi nga qeveria e Shteteve të bashkuara u nënshtrohen kufizimeve të përcaktuara në Dispozitat për të Drejtat në të Dhëna Teknike dhe Programe Kompjuterike (Rights in Technical Data and Computer Software Clauses) në DFARS 252.227-7013(c) (1) dhe FAR 52.227-19(c) (2) sipas rastit. Emra të tjerë produktesh dhe kompanish të përmendura në këtë dokument mund të jenë marka tregtare të pronarëve përkatës. Të gjitha ato të drejta nga të cilat nuk është hequr dorë shprehimisht, mbeten të rezervuara. Ilustrimet jepen për qëllime shembëllzimi, dhe mund të mos i përgjigjen përpikmërisht telefonit që keni në dorë.


## Simbole udhëzuese

Në udhëzues mund të përdoren këto simbole.

 Shënim

 Këshillë

 Vini Re!

 Shërbimi ose funksioni varen nga rrjeti ose nga pajtimtaria. Lidhuni me operatorin e rrjetit për hollësi të mëtejshme.


> Përdorni një tast funksional ose lundrimi për t'u zhvendosur dhe për të përzgjedhur. Shihni *Lundrimi* në f. 14.

## Për të filluar


### Montimi

Para se të filloni të përdorni telefonin, duhet të futni atje kartën SIM dhe baterinë.

#### Për të futur kartën SIM




- 1 Shkyçeni dhe hiqeni mbulesën e baterisë.




- 2 Rrëshqiteni kartën SIM në mbajtësen e vet, me kontaktet ngjyrë ari të kthyer nga poshtë.

#### Për të futur baterinë



- 1 Futeni baterinë me anën e etiketës nga lart dhe kontaktet elektrike të kthyer nga njëri-tjetri.




- 2 Rrëshqiteni mbulesën e baterisë derisa të të zërë vend mirë.



## Për ta ndezur telefonin

### Për ta ndezur telefonin



- 1 Shtypni pak çaste ①.
- 2 Futni kodin PIN të kartës SIM, po t'ju kërkohet, dhe përzgjidhni **OK**.
- 3 Përzgjidhni një gjuhë.
- 4 Përzgjidhni **Vazhdo** për ta përdorur udhëzoren e konfigurimit gjatë kohës që po shkarkohen cilësimet për Internet dhe për mesazhe-figurë.

💡 Për të ndrequr ndonjë gabim gjatë futjes së PIN-it, shtypni **C**.

! Para se ta fikni telefonin, duhet të ktheheni në gatishmëri.

## Karta SIM

Karta SIM (Modul i Identitetit të Pajtimtarit, ose Subscriber Identity Module në anglishte), të cilën do t'ju japë operatori i rrjetit, përmban të dhëna për pajtimtarinë tuaj. Gjithnjë fikeni telefonin dhe shkëputeni batingarkuesin, para se të futni ose të hiqni kartën SIM.

💡 Mund t'i ruani kontaktet në kartën SIM, para se ta hiqni nga telefoni. Shihni Për të kopjuar emra dhe numra në kartën SIM në f. 33.

## PIN

Për të aktivizuar shërbimet dhe funksionet në telefon, mund t'ju duhet të paraqitni një numër PIN (Numër të Identitetit Personal, ose Personal Identification Number në anglishte). Kodin PIN jua jep operatori i rrjetit. Çdo shifër e kodit PIN do të afishohet si \*, përveçse kur kodit vetë nis me shifrat e numrit të urgjencës, për shembull 112 ose 911. Kështu ju mund të shihni dhe t'i telefononi një numri të urgjencës, pa qenë nevoja të futni një PIN.

- ! Në qoftë se e futni gabim kodin PIN tri herë radhazi, karta SIM do të bllokohet. Shihni Kyçji i kartës SIM në f. 66.

## Gatishmëria

Pasi ta keni ndezur telefonin dhe të keni futur kodin PIN, në ekran do të afishohet emri i operatorit të rrjetit. Kjo pamje quhet gatishmëri. Telefoni juaj tani është gati për përdorim.

## Ndihma

Përveç këtij udhëzuesi, do të gjeni udhëzues Getting started («Për të filluar») dhe të dhëna të tjera në selinë [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support).

Telefoni përmban edhe tekste ndihmëse dhe të dhëna të tjera.

## *Për të parë këshilla dhe udhëzime përdorimi*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Të përgjithshme** > **Udhëzori i konfigur.**
- 2 Përzgjidhni **Këshilla & teknika**.

## *Për të parë të dhëna për funksionet*

- Shkoni te një funksion dhe përzgjidhni **Shtesat**.

## *Për të parë një video demonstrative të telefonit*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Dëfrim** > **Vizitë demo**.

## *Për të parë gjendjen e telefonit*

- Nga gatishmëria, shtypeni tastin e volumit lart. Do të afishohen të dhëna për telefonin, kujtesën dhe baterinë.

## Për të ngarkuar baterinë

Kur e bleni telefonin, bateria është pjesërisht e ngarkuar.


### Për të ngarkuar baterinë



- 1 Lidheni batingarkuesin me telefonin. Do të duhen përafërsisht 2,5 orë që bateria të ngarkohet plotësisht. Shtypni një tast çfarëdo për të parë ekranin.




- 2 Shkëputeni ngarkuesin duke e përkulur spinën së larti.


 *Telefonin mund ta përdorni edhe kur është duke u ngarkuar. Baterinë mund ta ngarkoni në çdo kohë, për më shumë ose më pak se 2,5 orë. Bateria nuk do të dëmtohet sikur ta ndërprisni ngarkimin.*

## Vështrim i përgjithshëm mbi telefonin

- 1 Mikrofolësi
- 2 Ekran
- 3 Tastet funksionale
- 4 Tasti i telefonimit
- 5 Tasti i menisë së veprimeve
- 6 Tasti funksional
- 7 Tasti kyçës
- 8 Mikrofolësi
- 9 Tasti i heshtimit
- 10 Tasti i kameras
- 11 Tasti C (Fshij)
- 12 Tasti Fund, tasti Ndiz/Fik
- 13 Tastet e volumit dhe të zoom-it të kameras
- 14 Kapësja e mbulesës së baterisë



- 15 Syri i kameras
- 16 Pasqyra për vetëportret
- 17 Kapësja e rripit
- 18 Priza për batingarkuesin, sistemin pa duar dhe kabllon USB.
- 19 Foleja e kartës së kujtesës
- 20 Kapësja e mbulesës së baterisë
- 21 Mikrofolësi
- 22 Drita për foto, llampa, drita treguese e videos



## Pamje e përgjithshme e menuve



PlayNow™\*



Internet\*



Dëfrim

Shërbime në linjë\*  
TrackID™  
Shërbimet orientuese  
Lojra  
VideoDJ™  
PhotoDJ™  
MusicDJ™  
Telekomandimi  
Regjistrim zëri  
Vizitë demo



Kamera



Mesazhimi

Krijoi të ri  
Kutia në hyrje  
PE  
Skica  
Kutia në dalje  
Mesazhe dërguar  
Mesazhe ruajtur  
Shokët e mi\*  
Tlfn. pst.zanore  
Modelet  
Trajto mesazhet  
Cilësimet



Media

Foto  
Muzikë  
Video  
Lojëra  
TV  
Burime Interneti  
Cilësimet



Alarmet



Kontaktet

Unë vetë  
Kontakt i ri



Radio



## Telefonatat\*\*



Të gjitha



Të përgjigjura



Të kryera



Të humbura



## Organizuesi

Skedari\*\*  
 Aplikacione  
 Telefonatë video  
 Kalendari  
 Detyrat  
 Shënime  
 Sinkronizimi  
 Kohëmatësi  
 Kronometri  
 Llampa  
 Llogaritësj  
 Kujtesa e kodeve



## Cilësimet\*\*



Të përgjithshme

Profillet  
 Ora dhe data  
 Gjuha  
 Shërbimi përditsues  
 Komandimi zanor  
 Ngjarje të reja  
 Shkurtoret  
 Avion  
 Sigurshmëria  
 Udhëzori i konfigur.  
 Përdorshmëria\*  
 Gjendja telefonit  
 Ricilëso të gjitha



Tinguj & sinjalizime

Volumi i ziles  
 Toni i ziles  
 Heshtim  
 Zile rritëse  
 Me dridhje  
 Sinjalizim mesazhi  
 Tingulli i tastit



Ekрани

Sfondi  
 Pamja menu kryes  
 Tema  
 Ekрани në hapje  
 Ekran-ruajtësja  
 Përmasat e orës  
 Ndriçimi  
 Ndrysho.em.linjave\*



Telefonatat

Telefonim i shpejtë  
 Kërkimi inteligjent  
 Devijio telefonat  
 Kalo te linja 2\*  
 Trajto telefonat  
 Kohëzgjatja &  
 Kosto\*  
 Afisho/fshihe num.  
 Pa duar



Lidhshmëria


Bluetooth  
 USB  
 Emri i telefonit  
 Ekspozimi në rrjet  
 Sinkronizimi  
 Trajtim pajisjesh  
 Rrjetet celulare  
 Komun. të dhënash\*  
 Cilësime Interneti  
 Cilësime lexim tranzit  
 Cilësime për mesazhe\*  
 Cilësimet SIP  
 Pajisjet shitesë

\* Disa menu varen nga operatori, rrjeti dhe pajtimtaria.

\*\* Përdorni tastin e lundrimit për t'u zhvendosur mes kartelave në nën-menutë. Për të dhëna të mëtejshme, shihni Lundrimi në f. 14.

## Lundrimi

*Për të lundruar në menutë e telefonit*



- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja**.
- 2 Përdorni tastin e lundrimit për t'u zhvendosur nëpër menutë.

*Për të përzgjedhur veprimet në ekran*

- Shtypni tastin funksional majtas, qendror ose djathtas.

*Për të parë shtesa për një objekt*

- Përzgjidhni **Shtesat** për shembull, për të bërë ndryshime.

*Për të përfunduar një funksion*

- Shtypni .


*Për t'u kthyer në gatishmëri*

- Shtypni .

*Për të lundruar në mediat*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Media**.
- 2 Shkoni te një zë i menisë dhe shtypni tastin e lundrimit djathtas.
- 3 Për t'u kthyer mbrapa, shtypni tastin e lundrimit majtas.

*Për të fshirë objekte*

- Shtypni  për të fshirë objekte të tilla si numra, shkronja, foto ose skeda zanore.

**Kartelat**

Menutë mund të përdorin kartela.

Për shembull, **Cilësimet** kanë kartela.



*Për t'u zhvendosur nëpër kartela*





- Shtypni tastin e lundrimit majtas ose djathtas.

**Shkurtoret**

Mund të përdorni shkurtore të tastierës për të shkuar drejtpërdrejt te funksionet që dëshironi.



## ***Për të përdorur shkurtoret e tastit të lundrimit***

- Nga gatishmëria, shtypni , ,  ose  për të shkuar drejtpërdrejt te një funksion.






## ***Për t'i ndryshuar shkurtoret e tastit të lundrimit***

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Të përgjithshme** > **Shkurtoret**.
- 2 Shkoni te një mundësi shtesë dhe përzgjidhni **Ndrysh**.
- 3 Shkoni te një mundësi shtesë menuje dhe përzgjidhni **Shkurt**.

## **Shkurtoret e menisë kryesore**

Numërimi i menuve nis nga ikona lart majtas dhe lëviz nga e majta në të djathtë, pastaj sipas radhëve.

## ***Për të shkuar drejtpërdrejt te një menu kryesore***

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** dhe shtypni  – ,  ose  ose .

- ! **Parametri *Pamja menu kryes* duhet cilësuar si *Tabelë*. Shihni *Për t'ia ndryshuar pamjen menisë kryesore*. në f. 65.**

## **Menuja e veprimeve**

Menuja e veprimeve ju lejon të futeni menjëherë në sa vijon:

- **Ngjarje të reja** – telefonata të humbura dhe mesazhe të reja.
- **Aplikac. aktive** – aplikacione që janë aktive në sfond.
- **Shkurtoret e mia** – shtoni funksionet tuaja të preferuara, që t'i aktivizoni shpejt.
- **Internet** – për t'u futur në Internet pa vonesë.

## ***Për ta hapur menunë e veprimeve***

- Shtypni .

## **Kujtesa**

Të dhënat për kontaktet mund t'i ruani në kartën e kujtesës, në kujtesën e telefonit dhe në kartën SIM. Fotot dhe muzika do të ruhen në kartën e kujtesës, po të keni një të tillë në telefon. Nëse nuk keni kartë kujtese, ose nëse karta e kujtesës është plot, do të ruhen në kujtesën e telefonit. Mesazhet dhe kontaktet do të ruhen në kujtesën e telefonit, por ju mund të vendosni t'i ruani në kartën SIM.


## Karta e kujtesës

Telefoni juaj përballon kartën e kujtesës Memory Stick Micro™ (M2™), e cila i shton hapësirë arkivimi telefonit. Njëkohësisht, mund të përdoret si kartë kujtese portative, me pajisje të tjera kompatibël.

Mund të zhvendosni materiale midis kartës së kujtesës dhe kujtesës së telefonit. Shihni *Trajtimi i materialeve në telefon* në f. 23.


- ! **Kartën e kujtesës mund t'ju duhet ta bleni veçmas.**

## Për të futur kartën e kujtesës



- Futeni kartën e kujtesës me kontaktet ngjyrë ari të kthyer nga poshtë.

## Për të hequr kartën e kujtesës



- Shtypeni buzën e kartës së kujtesës për ta liruar kartën nga foleja e vet dhe hequr nga telefoni.

## Për të parë mundësi shtesë të kartës së kujtesës

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja > Organizuesi > Skedari > kartela Në kartën e kujtesës.**
- 2 Përzgjidhni **Shtesat.**

## Gjuha në telefon

Mund të përzgjidhni se ç'gjuhë do të përdorni në telefon.

### *Për ta ndërruar gjuhën në telefon*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Të përgjithshme** > **Gjuha** > **Gjuha e telefonit**.
- 2 Përzgjidhni një mundësi shtesë.

### **Për të futur tekst**

Tekstin mund ta futni me mënyrën shumëshpëse ose me mënyrën T9™ Text Input **T9**. Mënyra T9 Text Input përdor një fjalor të posaçëm.

#### *Për ta ndryshuar mënyrën e futjes së tekstit*

- Kur futni tekst, shtypni pak çaste **(\*) a/A m)**.

#### *Për t'u këmbyer midis shkronjave të mëdha dhe të vogla*

- Kur jeni duke futur tekst, shtypni **(\*) a/A m)**.

#### *Për të futur numra*

- Kur futni tekst, shtypni pak çaste **(0 +)** - **(9)**.

### *Për të futur pika dhe presje*




- Kur jeni duke futur tekst, shtypni **(1)**.

### *Për të futur një simbol*



- 1 Kur jeni duke futur tekst, përzgjidhni **Shtesat** > **Shto simbol**.
- 2 Shkoni te një simbol dhe përzgjidhni **Ndërfute**.

### *Për të futur tekst me mënyrën T9™ Text Input*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni, për shembull, **Menuja** > **Mesazhimi** > **Krijoi të ri** > **Mszh shkrimor**.
- 2 Po të mos afishohet shenja **T9**, shtypni pak çaste **(\*) a/A m)** për t'u këmbyer në T9 Text Input.
- 3 Shtypeni çdo tast vetëm një herë, edhe sikur shkronja që dëshironi të përftoni të mos jetë e para në tast. Për shembull, për të shkruar fjalën «Jane», shtypni **(5)**, **(2)**, **(6)**, **(3)**. Shkruajeni krejt fjalën para se të shihni sugjerimet.

- Përdorni  ose  për të parë sugjerime.
- Shtypni  për ta pranuar fjalën që ju sugjerohet.

### ***Për të futur tekst me mënyrën shumëshlypëse***

- Nga gatishmëria përzgjidhni, për shembull, **Menuja > Mesazhimi > Krijoni të ri > Mszh shkrimor.**
- Po të afishohet shenja **T9**, shtypni pak çaste  për t'u këmbyer në mënyrën shumëshlypëse.
- Shtypni **2** – **9** disa herë, derisa të afishohet shkronja që dëshironi.
- Kur ta keni shkruar fjalën, shtypni  për të shtuar një hapësirë fjalëndarëse.

### ***Për t'i shtuar fjalë fjalorit në telefon***

- Kur futni tekst me mënyrën T9 Text Input, përzgjidhni **Shtesat > Spelloje fjalën.**
- Shkruajeni fjalën me mënyrën shumëshlypëse dhe përzgjidhni **Ndërfute.**

## **Muzika**

Mund të dëgjoni muzikë, audiolibra dhe podkaste. Përdorni *Sony Ericsson Media Manager* për të shkëmbyer materiale me telefonin. Shihni *Për të shkëmbyer materiale me një kompjuter* në f. 24 për të dhëna të mëtejshme.

### **Sistemi stereo portativ pa duar**



#### ***Për të përdorur sistemin pa duar***

- Lidhni sistemin portativ pa duar me telefonin. Muzika do të ndërpritet kur t'ju mbërrijë një telefonatë dhe do të vazhdojë kur të ketë përfunduar telefonata.

## Riprodhuesi muzikor



### *Për të dëgjuar muzikë*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Media** > **Muzikë**.
- 2 Përdorni tastin e lundrimit për të shfletuar sipas kategorisë.
- 3 Shkoni te një titull dhe përzgjidhni **Riprodho**.

### *Për ta ndaluar muzikën*

- Shtypni tastin qendror të lundrimit.

### *Për të shkuar përpara ose për t'u kthyer prapa me shpejtësi*

- Shtypni pak çaste  ose .

### *Për t'u zhvendosur midis titujve*

- Shtypni  ose .

### *Për ta minimizuar riprodhuesin*

- Kur jeni duke dëgjuar muzikë, përzgjidhni **Shtesat** > **Minimizo**.


### *Për t'u kthyer te riprodhuesi*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Media**.

### Listat e dëgjimit


Mund të krijoni lista dëgjimi për të organizuar muzikën që keni. Titujt mund t'i shtohen më shumë se një liste dëgjimi.

Po të fshini një listë dëgjimi, ose një titull nga një listë dëgjimi, skeda përkatëse do të mbetet në kujtesë, vetëm referenca do të fshihet.

 *Telefonit mund t'i duhen disa minuta për të krijuar një listë dëgjimi.*

### *Për të krijuar një listë dëgjimi*


- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Media** > **Muzikë** > **Listat e titujve**.
- 2 Shkoni te **Listë dëgjimi e re** dhe përzgjidhni **Shto**.
- 3 Futni një emër dhe përzgjidhni **OK**.
- 4 Sa herë që doni të shtoni një titull, shkoni te titulli dhe përzgjidhni **Shenjo**.
- 5 Përzgjidhni **Shto** për t'ia shtuar titujt listës së dëgjimit.

 *Mund t'i shtoni regjistra një liste dëgjimi. Të gjithë titujt në atë regjistrë do t'i bashkëlidhen listës së dëgjimit.*

### *Për t'i shtuar tituj një liste dëgjimi*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Media** > **Muzikë** > **Listat e titujve**.
- 2 Përzgjidhni një listë dëgjimi.
- 3 Shkoni te **Shto muzikë** dhe përzgjidhni **Shto**.
- 4 Sa herë që doni të shtoni një titull, shkoni te titulli dhe përzgjidhni **Shenjo**.
- 5 Përzgjidhni **Shto** për t'ia shtuar titujt listës së dëgjimit.

## ***Për të fshirë tituj nga një listë dëgjimi***


- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Media** > **Muzikë** > **Listat e titujve**.
- 2 Përzgjidhni një listë dëgjimi.
- 3 Shkoni te titulli dhe shtypni .

## **Audiolibrat**

Mund të dëgjoni audiolibra që keni transferuar në telefon nga kompjuteri, me anë të programit *Sony Ericsson Media Manager*.

- ! *Mund të duhet të kalojnë disa minuta para se një audiolibër të afishohet në listën e audiolibrave që mund të dëgjoni.*

## ***Për t'u futur në audiolibrat***

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Media** > **Muzikë** > **Audiolibrat**.
-  *Audiolibrat në formate të ndryshme nga M4B ose audiolibra që nuk kanë etiketa ID3v2 për kapitujt, do të gjenden në regjistrin **Titujt**.*

## **PlayNow™**

Mund të lidheni me shërbimin PlayNow™ për të shkarkuar tone zileje, lojëra, muzikë, tema dhe sfonde. Këto mund t'i shihni paraprakisht ose t'i dëgjoni para se t'i bleni dhe t'i shkarkoni në telefon.

Nëse nuk e përdorni dot PlayNow™, shihni *Mënjanimi i problemeve* në f. 69.

- ! *Ky shërbim nuk mund të përdoret në të gjitha vendet.*

## ***Për të përdorur PlayNow™***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **PlayNow™**.
- 2 Shfletoni selinë e PlayNow™ në Internet dhe ndiqni udhëzimet për të parë materialet paraprakisht dhe për t'i blerë.

## **TrackID™**


TrackID™ është shërbim identifikues muzikor. Mund të kërkonti titullin, artistin dhe emrin e albumit të një pjese muzikore që e dëgjoni të riprodhuar nga altoparlanti ose të luajtur në radio.

Nëse nuk e përdorni dot TrackID™, shihni *Mënjanimi i problemeve* në f. 69.

- ! *Lidhuni me ofruesin e shërbimit për të dhëna në lidhje me koston.*

## ***Për të kërkuar të dhëna për pjesët***

- Kur dëgjoni të luhet një këngë në altoparlant, nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Dëfrim** > **TrackID™** > **Nise**.
- Kur po dëgjoni radion, përzgjidhni **Shtesat** > **TrackID™**.

-  *Për rezultat sa më të mirë, përdoreni TrackID™ në një mjedis pa zhurmë.*

## Muzika dhe videoklipet në Internet

Mund të shihni videoklipe dhe të dëgjoni muzikë duke i lexuar tranzit, nëpërmjet telefonit, në Internet. Nëse nuk e përdorni dot Internetin, shihni *Mënjanimi i problemeve* në f. 69.

### *Për të përzgjedhur një llogari dhanore për lexim tranzit*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Lidhshmëria** > **Cilësime lexim tranzit** > **Lidhu me:**.
- 2 Përzgjidhni llogarinë dhanore që do të përdorni.
- 3 Përzgjidhni **Ruaje**.

### *Për të lexuar tranzit muzikë dhe videoklipe*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Internet**.
- 2 Përzgjidhni **Shtesat** > **Shko te** > **Kujtesoret**.
- 3 Përzgjidhni një njeje nga ku do të lexoni tranzit.

## Riprodhuesi video

### *Për të luajtur video*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Media** > **Video** > **Videot**.
- 2 Shkoni te një titull dhe përzgjidhni **Riprodo**.

### *Për ta ndalur riprodhimin video*

- Shtypni tastin funksional qendror.

## Radio

### *Për të dëgjuar radion*

- 1 Lidhni sistemin pa duar me telefonin.
- 2 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Radio**.

### *Për të kërkuar automatikisht kanale*

- Përzgjidhni **Kërko**.

### *Për të kërkuar manualisht kanale*

- Shtypni  ose .

### *Për ta ndryshuar volumin*

- Shtypni tastet e volumit lart ose poshtë.

### *Për ta minimizuar radion*

- Kur po dëgjoni radion, përzgjidhni **Shtesat** > **Minimizo**.

### *Për t'u kthyer te radioja*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Radio**.

### *Për t'i ruajtur kanalet*

Mund të ruani deri në 20 kanale të paracilësuar.

### *Për të ruajtur kanale*

- 1 Kur të keni gjetur një kanal të radios, përzgjidhni **Shtesat** > **Ruaje**.
- 2 Shkoni te një pozicion dhe përzgjidhni **Ndërfute**.

### *Për të përzgjedhur kanale që keni ruajtur*

- 1 Përzgjidhni **Shtesat** > **Kanalet**.
- 2 Përzgjidhni një kanal radio.





### *Për t'u këmbyer midis kanaleve të ruajtura*

- Shtypni  ose .

## **MusicDJ™**


Mund të kompozoni dhe të përpunoni meloditë tuaja, për t'i përdorur pastaj si tone zileshe. Mund të përdorni tinguj të strukturuar me karakteristika të ndryshme.

### *Për të kompozuar një melodi*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Dëfrim** > **MusicDJ™**.
- 2 Përzgjidhni nëse tingujt do t'i **Fute**, **Kopjoje** apo **Ngjite**.
- 3 Përdorni , ,  ose  për t'u zhvendosur nëpër tinguj.
- 4 Përzgjidhni **Shtesat** > **Ruaje melodinë**.

## **Regjistrimi zanor**

Mund të regjistroni një memo zanore ose një telefonatë. Tingujt e regjistruar mund të cilësohen si tone zileshe.

-  *Në disa vende ose shtete ligji kërkon që ta informoni palën tjetër para se të filloni ta regjistroni bisedën telefonike.*

### *Për të regjistruar tingull*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Dëfrim** > **Regjistrim zëri** > **Regjistro**.

### *Për të regjistruar një telefonatë*

- 1 Gjatë telefonatës, përzgjidhni **Shtesat** > **Regjistro**.
- 2 Përzgjidhni **Ruaje** për ta ruajtur regjistrimin.


### *Për ta dëgjuar regjistrimin*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Organizuesi** > **Skedari**.
- 2 Shkoni te **Muzikë** dhe përzgjidhni **Hape**.
- 3 Shkoni te një regjistrim dhe përzgjidhni **Ripr**.



# Transferimi dhe trajtimi i materialeve

Mund të transferoni dhe të trajtoni materiale të tilla si foto dhe muzikë.

! *Nuk ju lejohet të shkëmbeni disa materiale të mbrojtura me të drejta autori. Shenja  tregon se skeda është e mbrojtur.*

## Trajtimi i materialeve në telefon

**Skedari** mund të përdoret për të trajtuar materiale që ruani në kujtesën e telefonit ose në një kartë kujtese. Kartelat dhe ikonat në **Skedari** tregojnë se ku ruhen materialet. Nëse kujtesa është plot, fshini ndonjë material për të hapur vend.

### *Për të parë gjendjen e kujtesës*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Organizuesi** > **Skedari**.
- 2 Përzgjidhni **Shtesat** > **Gjendja e kujtesës**.
- 3 Përzgjidhni **Karta e kujtesës** ose **Telefon**.

### *Për të përzgjedhur disa objekte në një regjistër*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Organizuesi** > **Skedari**.
- 2 Shkoni te një regjistër dhe përzgjidhni **Hape**.
- 3 Përzgjidhni **Shtesat** > **Shenjo** > **Shenjo disa**.

- 4 Sa herë që doni të shenjoni një objekt, shkoni tek objekti dhe përzgjidhni **Shenjo**.

### *Për të zhvendosur objekte midis kartës së kujtesës dhe kujtesës së telefonit*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Organizuesi** > **Skedari**.
- 2 Gjeneroni një objekt dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Trajto skedën** > **Zhvendose**.
- 3 Përzgjidhni **Karta e kujtesës** ose **Telefon**.
- 4 Shkoni te një regjistër dhe përzgjidhni **Hape**.
- 5 Përzgjidhni **Ngjite**.

### *Për të parë të dhëna për materialet*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Organizuesi** > **Skedari**.
- 2 Gjeneroni një objekt dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Informacion**.

## Për t'i dërguar materiale një telefoni tjetër

Mund të dërgoni materiale, për shembull, me anë mesazhesh ose duke përdorur radioteknologjinë Bluetooth™.

### *Për të dërguar materiale*

- 1 Shkoni te një objekt dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Dërgoje**.
- 2 Përzgjidhni një mënyrë transferimi.

- ! Sigurohuni që pajisja marrëse e përballon mënyrën e transferimit që keni përzgjedhur.

## **Për të shkëmbyer materiale me një kompjuter**

Mund të përdorni programin *Sony Ericsson Media Manager* për të shkëmbyer materiale midis telefonit dhe një kompjuteri.

- ! Programin *Sony Ericsson Media Manager* do ta gjeni në CD-në që ju ka ardhur me telefonin ose mund ta shkarkoni nga [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support).

Kur zhvendosni ose kopjoni materiale nga një kompjuter në telefon, materialet që telefoni nuk arrin t'i kategorizojë do të ruhen në regjistrin **Tjetrin** në skedar.

### **Sistemet operuese të nevojshme**

Për të përdorur programet që ju vijnë në CD, ju duhet një nga këto sisteme operuese:

- Microsoft® Windows Vista™ versionet 32 bit dhe 64 bit të: Ultimate, Enterprise, Business, Home Premium ose Home Basic
- Microsoft® Windows XP (Pro ose Home), Service Pack 2 ose më tej

### **Për të instaluar programin Sony Ericsson Media Manager**

- 1 Ndizeni kompjuterin dhe futni CD-në. CD-ja do të nisët automatikisht dhe do të hapë një dritare të instalimit.
- 2 Përzgjidhni një gjuhë dhe klikoni OK.
- 3 Klikoni mbi *Install Sony Ericsson Media Manager* dhe ndiqni udhëzimet.

### **Për të transferuar material me anë të Sony Ericsson Media Manager**

- ! Mos e shkëputni kabllon USB nga telefoni ose nga kompjuteri gjatë transferimit, pse kjo mund ta dëmtojë kujtesën e telefonit.
- 1 Lidhni telefonin me një kompjuter me anë të një kabloje USB të përshtatshme.
  - 2 **Në kompjuter:** *Start/Programs/Sony Ericsson/Media Manager*.
  - 3 **Në telefon:** Përzgjidhni **Arkivim masiv**.
  - 4 **Në kompjuter:** Prisni derisa telefoni të afishohet në *Sony Ericsson Media Manager*.
  - 5 Zhvendosni skeda midis telefonit dhe kompjuterit në hapësirën e *Sony Ericsson Media Manager*.
  - 6 Për ta shkëputur pa rrezik kabllon USB, dжатhtas-klikoni mbi ikonën e diskut lëvizës (Removable disk) në *Windows Explorer* dhe përzgjidhni **Eject** (Nxirre).

- Të dhëna të mëtejshme lidhur me transferimin e skedave muzikore do të gjeni në Media Manager Help. Klikoni (?) në këndin lart djathtas të dritares së Sony Ericsson Media Manager.

## Përdorimi i kablos USB

Mund ta lidhni telefonin me një kompjuter me anë të kablos USB për të sinkronizuar, transferuar dhe arkivuar materialet në telefon, ose përdorur telefonin si modem. Për të dhëna të mëtejshme, shkoni te [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support) për të lexuar udhëzuesit *Getting started* (Për të filluar).



### Para se të përdorni kabllon USB

- Shihni *Sistemet operuese të nevojshme* në f. 24.

- ! Përdorni vetëm një kablo USB që përballon telefoni. Mos e shkëputni kabllon USB nga telefoni ose nga kompjuteri gjatë transferimit, pse kjo mund ta dëmtojë kujtesën e telefonit.

### Për ta shkëputur kabllon USB pa rrezik

- 1 Djathtas-klikoni mbi ikonën e diskut lëvizës në *Windows Explorer*.
- 2 Përzgjidhni *Eject*.
- 3 Shkëputeni kabllon USB pasi të afishohet në telefon një mesazh që ju lajmëron se mund ta kryeni këtë veprim pa rrezik.

- ! Mos i kopjoni skedat menjëherë, në qoftë se e keni formatuar diskun e telefonit në PC. Në atë rast, më parë shkëputeni kabllon USB dhe rinisni telefonin.

### Zhvendosni materiale me mënyrën zvarrit-dhe-lësho

Përdorni mënyrën zvarrit-dhe-lësho (drag-and-drop) në kompjuter për të transferuar materiale midis kujtesës së telefonit dhe kompjuterit në mjedisin *Microsoft Windows Explorer*.

### Për të zhvendosur materiale me mënyrën zvarrit-dhe-lësho

- 1 Lidhni telefonin me një kompjuter, nëpërmjet kablos USB.
- 2 Në telefon: Përzgjidhni **Arkivim masiv**.

- 3 **Në kompjuter:** Prisi derisa kujtesa e telefonit të afshohet si disk i jashtëm në *Windows Explorer*.
- 4 Zvarritni dhe lëshoni (drag-and-drop) skedat e përzgjedhura midis telefonit dhe kompjuterit.

## Emri i telefonit

Mund t'i vini një emër kompjuterit, i cili do t'u tregohet pajisjeve të tjera kur të përdorni, për shembull, radioteknologjinë Bluetooth™.


### *Për t'i vënë një emër telefonit*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Lidhshmëria** > **Emri i telefonit**.
- 2 Futni emrin e telefonit dhe përzgjidhni **OK**.

## Përdorimi i radioteknologjisë Bluetooth™

Funksioni Bluetooth bën të mundur që të lidheni pa tel me pajisje të tjera Bluetooth. Ju mundeni, për shembull:

- Të lidheni me pajisje pa duar.
- Të lidheni njëkohësisht me disa pajisje.
- Të lidheni me kompjuterin dhe të futeni në Internet.
- Të shkëmbeni objekte.
- Të luani lojëra shumëlojtarësh.


 *Pajisjet që përdorin komunikimin Bluetooth është mirë të mos mbahen më larg se 10 metra (33 fut) nga njëra-tjetra, pa objekte solide ndërmjet.*

## Para se të përdorni radioteknologjinë Bluetooth

Duhet ta aktivizoni funksionin Bluetooth për të komunikuar me pajisje të tjera. Mund edhe t'ju duhet ta çiftoni telefonin tuaj me pajisje të tjera Bluetooth.

### *Për ta aktivizuar funksionin Bluetooth*

- Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Lidhshmëria** > **Bluetooth** > **Aktivizojte**.

 *Sigurohuni që pajisja të cilën dëshironi ta çiftoni me telefonin e ka të aktivizuar funksionin Bluetooth dhe është e gjatshme.*

### *Për ta çiftuar telefonin me një pajisje*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Lidhshmëria** > **Bluetooth** > **Pajisjet e mia**.
- 2 Shkoni te **Pajisje e re** dhe përzgjidhni **Shto** për të kërkuar pajisje të përdorshme.
- 3 Përzgjidhni një pajisje.
- 4 Futni një kodkalim, nëse ju kërkohet.

### ***Për të lejuar lidhje me telefonin***

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja**  
> **Cilësimet** > kartela **Lidhshmëria**  
> **Bluetooth** > **Pajisjet e mia**.
- 2 Përzgjidhni një pajisje nga lista.
- 3 Përzgjidhni **Shtesat** > **Lejo lidhjen**.
- 4 Përzgjidhni **Gjithnjë pyet** ose **Gjithnjë lejo**.

❗ *Kjo mund të kryhet vetëm me pajisje që kërkojnë shërbim sigurshmërie.*

### ***Për ta çiftuar për herë të parë telefonin me një sistem Bluetooth pa duar***

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja**  
> **Cilësimet** > kartela **Lidhshmëria**  
> **Bluetooth** > **Pa duar**.
- 2 Përzgjidhni një pajisje.
- 3 Futni një kodkalim, nëse ju kërkohet.

### ***Kursimi i energjisë***

Funksioni Kursim energjie ju lejon të kurseni energjinë e baterisë. Kur jeni në profilin Kursim energjie mund të lidheni vetëm me një pajisje Bluetooth. Në qoftë se doni të lidheni me më shumë se një pajisje Bluetooth njëkohësisht, duhet ta çaktivizoni këtë funksion.

### ***Për të aktivizuar kursimin e baterisë***

- Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja**  
> **Cilësimet** > kartela **Lidhshmëria**  
> **Bluetooth** > **Kursim energjie**  
> **Aktivizoje**.

### ***Për të shkëmbyer tingull me një pajisje Bluetooth pa duar***

Mund të shkëmbeni tingull me një pajisje Bluetooth pa duar duke përdorur një tast të telefonit ose tastin e pajisjes pa duar.

### ***Për të shkëmbyer tingull***

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja**  
> **Cilësimet** > kartela **Lidhshmëria**  
> **Bluetooth** > **Pa duar** > **Telefonim në hyrje**.
- 2 Përzgjidhni një mundësi shtesë. **Në apart** e transferon tingullin drejt telefonit. **Te sist. pa-duar** e transferon tingullin drejt pajisjes pa duar.

### ***Për të shkëmbyer tingull gjatë një telefonate***

- 1 Gjatë telefonatës, përzgjidhni **Zëri**.
- 2 Përzgjidhni nga lista.

### ***Arkivimi dhe rikthimi***

Materialet që keni në telefon mund t'i arkivoni në një kompjuter me anë të programeve *Sony Ericsson PC Suite* dhe *Sony Ericsson Media Manager*. Me anë të programit *Sony Ericsson PC Suite* mund të arkivoni dhe të riktheni në telefon kontaktet, kalendarin, detyrat, shënimet dhe kujtesoret. Me anë të programit *Sony Ericsson Media*

Manager mund të arkivoni dhe të riktheni materiale të tilla si muzikë, foto dhe videoklipe.

Para se të arkivoni dhe të riktheni, duhet të instaloni *Sony Ericsson PC Suite* dhe the *Sony Ericsson Media Manager*.

- ! Gjithnjë bëni një kopje arkivuese para se ta gradoni telefonin, meqë gradimi mund t'i fshijë materialet që keni ruajtur në telefon.

**Për të bërë një kopje arkivuese (rezervë) me anë të Sony Ericsson PC Suite**

- 1 **Në kompjuter:** Niseni *Sony Ericsson PC Suite* nga *Start/Programs/Sony Ericsson/PC Suite*.
- 2 Ndiqni udhëzimet në *Sony Ericsson PC Suite* për mënyrën si duhet të lidheni.
- 3 **Në telefon:** Përzgjidhni **Modus Telefon**.
- 4 **Në kompjuter:** Shkoni te seksioni i arkivimit dhe rikthimit (backup and restore section) në *Sony Ericsson PC Suite* dhe bëni një kopje arkivuese (backup).

- ! Gjatë procesit të rikthimit, programi *Sony Ericsson PC Suite* do t'i mbishkruajë të gjitha materialet që keni në telefon. Po ta ndërprisni procesin, mund ta dëmtoni telefonin.

**Për të rikthyer materiale në telefon me anë të Sony Ericsson PC Suite**

- 1 **Në kompjuter:** Niseni *Sony Ericsson PC Suite* nga *Start/Programs/Sony Ericsson/PC Suite*.
- 2 Ndiqni udhëzimet në *Sony Ericsson PC Suite* për mënyrën si duhet të lidheni.
- 3 **Në telefon:** Përzgjidhni **Modus Telefon**.
- 4 **Në kompjuter:** Shkoni te seksioni i arkivimit dhe rikthimit (backup and restore section) në *Sony Ericsson PC Suite* dhe kryeni rikthimin (restore).

**Për të bërë një kopje arkivuese (rezervë) me anë të Sony Ericsson Media Manager**

- 1 Lidheni telefonin me kompjuterin, nëpërmjet kabllos USB.
- ! *Telefonin mund ta lidhni me një kompjuter edhe me anë të Bluetooth.*
- 2 **Në telefon:** Përzgjidhni profilin **Transferim media**.
- 3 **Në kompjuter:** Niseni *Sony Ericsson Media Manager* nga *Start/Programs/Sony Ericsson/Media Manager*.
- 4 Shkoni te seksioni i kopjimit arkivues (backup) në *Sony Ericsson Media Manager*.
- 5 Përzgjidhni skedat që dëshironi të arkivoni dhe kryeni një kopjim arkivues.

- ! *Programi Sony Ericsson Media Manager do të krahasojë materialet që keni në telefon me ato që keni arkivuar në kompjuter dhe do të rikthejë në telefon skedat që mungojnë. Po ta ndërprisni procesin, mund ta dëmtoni telefonin.*

### ***Për të rikthyer materiale në telefon me anë të Sony Ericsson Media Manager***

- 1 Lidheni telefonin me kompjuterin.
- 2 **Në telefon:** Përzgjidhni profilin **Transferim media**.
- 3 **Në kompjuter:** Niseni *Sony Ericsson Media Manager* nga *Start/Programs/Sony Ericsson/Media Manager*.
- 4 Shkoni te seksioni i kopjimit arkivues (backup) në *Sony Ericsson Media Manager*.
- 5 Përzgjidhni skedat që dëshironi të riktheni dhe kryeni rikthimin.


- ! *Të dhëna të mëtejshme për arkivimin dhe rikthimin me anë të Sony Ericsson Media Manager do të gjeni në udhëzuesin *Getting started (Për të filluar)* të Sony Ericsson Media Manager në [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support).*

## Telefonimi

### **Për të bërë dhe marrë telefonata**

Duhet ta ndizni telefonin dhe të jeni brenda rrezes së një rrjeti.

#### ***Për të bërë një telefonatë***



- 1 Nga gatishmëria futni numrin e telefonit (me prefiksin ndërkombëtar dhe prefiksin zonal, nëse ka të tillë).
- 2 Shtypni .

- 💡 *Mund t'u telefononi numrave nga kontaktet dhe lista e telefonatave. Shihni Kontaktet në f. 31, dhe Lista e telefonatave në f. 35. Mund edhe të telefononi nëpërmjet komandash zanore. Shihni Komandimi zanor në f. 36.*

#### ***Për ta përfunduar telefonatën***


- Shtypni .

#### ***Për të bërë telefonata ndërkombëtare***

- 1 Nga gatishmëria mbani të shtypur  derisa shenja «+» të afishohet në ekran.
- 2 Futni prefiksin e shtetit, prefiksin e zonës (pa zeron në krye) dhe numrin e telefonit.
- 3 Shtypni .

### ***Për t'i ritefonuar një numri***

- Kur të afishohet **Të provoj prapë?** përzgjidhni **Po**.

 **Nuk ka nevojë ta mbani telefonin në vesh gjatë kohës që prisni. Kur të lidhet telefonata, telefoni ju lajmëron me një sinjal të fortë.**

### ***Për t'iu përgjigjur një telefonate***

- Shtypni .



### ***Për të refuzuar një telefonatë***

- Shtypni .

### ***Për t'ia ndryshuar volumin mikrofolësit gjatë një telefonate***


- Shtypni tastin e volumit lart ose poshtë.

### ***Për ta fikur mikrofoning gjatë një telefonate***


- 1 Shtypni pak çaste .
- 2 Shtypni pak çaste  përsëri, për të vazhduar bisedën.

### ***Për të ndezur altoparlantin gjatë një telefonate***

- Përzgjidhni **Alt. ndz**.

 **Kur përdorni altoparlantin, mos e mbani telefonin te veshi. Mund t'ju dëmtohet dëgjimi.**

### ***Për të parë telefonatat e humbura nga gatishmëria***

- Shtypni  për të hapur listën e telefonatave.

### ***Rrjetet***


Telefoni juaj do të këmbëhet automatikisht midis rrjeteve GSM dhe 3G (UMTS), sipas përdorshmërisë. Disa operatorë rrjetesh ju lejojnë t'i këmbëni rrjetet ju vetë.

### ***Për t'i këmbyer rrjetet ju vetë***

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Lidhshmëria** > **Rrjetet celulare** > **Rrjetet GSM/3G**.
- 2 Përzgjidhni një mundësi shtesë.


### ***Telefonata të urgjencës***

Telefoni juaj përballon numrat ndërkombëtarë të urgjencës, si 112 dhe 911. Këta numra mund të përdoren normalisht për të bërë një telefonatë të urgjencës në çdo vend që të ndodhëni, me ose pa kartë SIM të instaluar, po të gjendeni brenda rrezes së një rrjeti.

 **Disa vende mund të përdorin numra të tjerë urgjence. Për këtë arsye, operatori juaj i rrjetit mund të ketë regjistruar numra të tjerë vendorë të urgjencës në kartën SIM.**




### *Për të bërë një telefonatë urgjence*

- Nga gatishmëria, futni 112 (numri ndërkombëtar i urgjencës) dhe shtypni .

### *Për të parë numrat tuaj vendorë të urgjencës*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Kontaktet**.
- 2 Shkoni te **Kontakt i ri** dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Numra specialë** > **Numra të urgjencës**.

### **Videotelefonata**

Mund ta shihni dikë në ekran gjatë telefonatës. Të dy palëve u nevojitet një pajtimtari që e përballon shërbimin 3G (UMTS) dhe ju duhet gjithashtu të jeni brenda rrezes së një rrjeti 3G (UMTS). Shërbimin 3G (UMTS) mund ta përdorni kur të afishohet në ekran ikona .

### *Për të bërë një videotelefonatë*

- 1 Nga gatishmëria futni numrin e telefonit (me prefiksin ndërkombëtar dhe prefiksin zonal, nëse ka të tillë).
- 2 Përzgjidhni **Shtesat** > **Bëj videotelef**.

### *Për të përdorur zoom-in me një videotelefonatë në dalje*

- Shtypni  ose .

### *Për të parë mundësi shtesë të videotelefonimit*

- Gjatë telefonatës, përzgjidhni **Shtesat**.

## **Kontaktet**

Në **Kontaktet** mund të ruani emra, numra telefoni dhe të dhëna personale. Të dhënat mund t'i ruani në kujtesën e telefonit ose në kartën SIM.



*Kontaktet mund t'i sinkronizoni me anë të programit Sony Ericsson PC Suite.*

### **Kontaktet default**

Ju vetë mund ta caktoni se çfarë të dhënash të kontaktit do të afishohen si default. Po të përzgjidhni **Kontaktet telef**, si default, në kontaktet do të afishohet gjithë informacioni i ruajtur në **Kontaktet**. Po të përzgjidhni **Kontaktet SIM** si default, në kontaktet do të afishohen emrat dhe numrat e ruajtur në kartën SIM.

### *Për të përzgjedhur kontaktet default*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Kontaktet**.
- 2 Shkoni te **Kontakt i ri** dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Të avancuara** > **Kontakte default**.
- 3 Përzgjidhni një mundësi shtesë.

## Kontaktet në telefon


Kontaktet në telefon mund të përbajjnë emra, numra telefoni dhe të dhëna personale. Këto do të ruhen në kujtesën e telefonit.

### *Për të shtuar një kontakt në telefon*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Kontaktet**.
- 2 Shkoni te **Kontakt i ri** dhe përzgjidhni **Shto**.
- 3 Futeni emrin dhe përzgjidhni **OK**.
- 4 Shkoni te **Numër i ri**: dhe përzgjidhni **Shto**.
- 5 Futni numrin dhe përzgjidhni **OK**.
- 6 Përzgjidhni një mundësi shtesë për numrin.
- 7 Lundroni midis kartelave dhe shtoni të dhëna në fushat përkatëse.
- 8 Përzgjidhni **Ruaje**.

### **Për t'u telefonuar kontakteve**


#### *Për t'i telefonuar një kontakti në telefon*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Kontaktet**.
- 2 Shkoni te një kontakt dhe shtypni .

#### *Për të shkuar menjëherë te lista e kontakteve*

- Nga gatishmëria, mbani të shtypur **(2)** – **(9)**.

## *Për të telefonuar duke përdorur Kërkimin inteligjent*

- 1 Nga gatishmëria shtypni **(0+)** – **(9)** për të futur një varg prej së paku dy shifrash. Do të afishohet një listë me të gjitha kryefjalët që përkojnë me atë varg shifrash ose shkronjash përkatëse.
- 2 Shkoni te një kontakt ose numër telefoni dhe shtypni .


### *Për ta aktivizuar ose çaktivizuar funksionin e Kërkimit inteligjent*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Telefonatat** > **Kërkimi inteligjent**.
- 2 Përzgjidhni një mundësi shtesë.

### **Për të bërë ndryshime në kontaktet**

#### *Për t'i shtuar të dhëna një kontakti në telefon*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Kontaktet**.
- 2 Shkoni te një kontakt dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Ndrysho kontakt**.
- 3 Zhvendosuni nëpër kartela dhe përzgjidhni **Shto** ose **Ndrysh**.
- 4 Përzgjidhni një mundësi shtesë dhe një objekt për të modifikuar ose shtuar.
- 5 Përzgjidhni **Ruaje**.


-  Në rast se pajtimtaria juaj e përballon shërbimin e identifikimit të linjës telefonuese (CLI), kontakteve mund t'u caktoni imazhe dhe tone zilësh personale.

### ***Për të kopjuar emra dhe numra në kontaktet në telefon***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Kontaktet**.
- 2 Shkoni te **Kontakt i ri** dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Të avancuara** > **Kopjo nga SIM**.
- 3 Përzgjidhni një mundësi shtesë.

### ***Për të kopjuar emra dhe numra në kartën SIM***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Kontaktet**.
- 2 Shkoni te **Kontakt i ri** dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Të avancuara** > **Kopjo në SIM**.
- 3 Përzgjidhni një mundësi shtesë.

-  *Kur i kopjoni të gjitha kontaktet nga telefoni në kartën SIM, të gjitha të dhënat ekzistuese në kartën SIM do të zëvendësohen.*

### ***Për t'i ruajtur emrat dhe numrat e telefonit automatikisht në kartën SIM***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Kontaktet**.
- 2 Shkoni te **Kontakt i ri** dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Të avancuara** > **Vetëruaj në SIM**.
- 3 Përzgjidhni një mundësi shtesë.


### **Kontaktet në SIM**

Kontaktet në SIM mund të përbajnë vetëm emra dhe numra. Këto ruhen në kartën SIM.

### ***Për të shtuar një kontakt në SIM***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Kontaktet**.
- 2 Shkoni te **Kontakt i ri** dhe përzgjidhni **Shto**.
- 3 Futni emrin dhe përzgjidhni **OK**.
- 4 Futni numrin dhe përzgjidhni **OK**.
- 5 Përzgjidhni një mundësi shtesë për numrin dhe shtoni të dhëna të tjera, nëse i keni.
- 6 Përzgjidhni **Ruaje**.

### ***Për t'i telefonuar një kontakti në SIM***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Kontaktet**.
- 2 Shkoni te një kontakt dhe shtypni .

## Për të fshirë kontakte

### *Për t'i fshirë të gjitha kontaktet*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Kontaktet**.
- 2 Shkoni te **Kontakt i ri** dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Të avancuara** > **Fshij gjithë kontaktet**.
- 3 Përzgjidhni një mundësi shtesë.

### **Gjendja e kujtesës së kontakteve**

Se sa kontakte mund të ruani në telefon ose në kartën SIM, kjo varet nga kujtesa e përdorshme.

### *Për të parë gjendjen e kujtesës së kontakteve*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Kontaktet**.
- 2 Shkoni te **Kontakt i ri** dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Të avancuara** > **Gjendja e kujtesës**.

### **Unë vetë**

Mund të futni të dhëna për veten dhe, për shembull, të dërgoni kartëvizitën tuaj.

### *Për të futur të dhëna për Vetën*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Kontaktet**.
- 2 Shkoni te **Unë vetë** dhe përzgjidhni **Hape**.

- 3 Shkoni te një mundësi shtesë dhe ndryshojini të dhënat.
- 4 Përzgjidhni **Ruaje**.

### *Për të shtuar kartëvizitën tuaj*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Kontaktet**.
- 2 Shkoni te **Unë vetë** dhe përzgjidhni **Hape**.
- 3 Shkoni te **Info ime kontakti** dhe përzgjidhni **Shto** > **Krijo të re**.
- 4 Lundroni midis kartelave dhe shtoni të dhëna në fushat përkatëse.
- 5 Futni të dhënat dhe përzgjidhni **Ruaje**.

### **Grupet**

Mund të krijoni një grup me numra telefoni dhe adresa të postës elektronike nga **Kontaktet telef.** për t'u dërguar mesazhe. Shihni *Mesazhimi* në f. 41. Grupet (me numra telefoni) mund t'i përdorni edhe kur krijoni lista telefonuesish të pranuar. Shihni *Pranimi i telefonatave* në f. 39.

### *Për të krijuar një grup me numra dhe adresa PE*



- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Kontaktet**.
- 2 Shkoni te **Kontakt i ri** dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Grupet**.
- 3 Shkoni te **Grup i ri** dhe përzgjidhni **Shto**.

- 4 Vëri një emër grupit dhe përzgjidhni **Vazhdo**.
- 5 Shkoni te **I ri** dhe përzgjidhni **Shto**.
- 6 Për të shenjuar një numër telefoni të një kontakti ose një adresë PE, shkoni atje dhe përzgjidhni **Shenjo**.
- 7 Përzgjidhni **Vazhdo** > **Mbarova**.


## Lista e telefonatave

Mund të shihni të dhëna për telefonatat që keni bërë së fundi.

### *Për t'i telefonuar një numri nga lista e telefonatave*

- 1 Nga gatishmëria, shtypni  dhe shkoni te një kartelë.
- 2 Shkoni te një emër ose numër dhe shtypni .

### *Për t'u shtuar kontakteve një numër nga lista e telefonatave*

- 1 Nga gatishmëria, shtypni  dhe shkoni te një kartelë.
- 2 Shkoni te numri dhe përzgjidhni **Ruaj**.
- 3 Përzgjidhni **Kontakt i ri** për të krijuar një kontakt të ri, ose përzgjedhur një kontakt ekzistues për t'ia shtuar numrin.


## Telefonimi i shpejtë

Funksioni i telefonimit të shpejtë ju lejon të përzgjidhni nëntë kontakte për t'u telefonuar shpejt. Këto kontakte mund t'i ruani në pozicionet 1-9.

### *Për t'u shtuar kontakte numrave të telefonimit të shpejtë*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Kontaktet**.
- 2 Shkoni te **Kontakt i ri** dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Telefonim i shpejtë**.
- 3 Shkoni te një numër pozicioni dhe përzgjidhni **Shto**.
- 4 Përzgjidhni një kontakt.

### *Për telefonim të shpejtë*

- Nga gatishmëria, futni numrin e pozicionit dhe shtypni .



## Posta zanore

Në qoftë se pajtimtaria juaj parashikon shërbim mesazherie, telefonuesit mund të lënë një mesazh në postën zanore sa herë që ju s'arrini t'i përgjigjeni një telefonate.

### *Për të futur numrin e postës zanore*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **Cilësimet** > **Num.postës.zanore**.
- 2 Futni numrin dhe përzgjidhni **OK**.

### *Për t'i telefonuar shërbimit të postës zanore*

- Nga gatishmëria, mbani të shtypur .

## Komandimi zanor

Duke krijuar komanda zanore ju mund të kryeni:

- Telefonim zanor – t'i telefononi dikujt duke ia shqiptuar emrin
- T'u përgjigjeni telefonatave ose t'i refuzoni, kur përdorni një sistem pa duar

### *Për të regjistruar një komandë zanore duke përdorur telefonimin zanor*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Të përgjithshme** > **Komandimi zanor** > **Telefonim zanor** > **Aktivizoje**.
- 2 Përzgjidhni **Po** > **Komnd. e re zanore** dhe përzgjidhni një kontakt. Nëse kontakti ka më shumë se një numër, përzgjidhni numrin të cilit do t'ia shtoni komandën zanore.
- 3 Regjistroni një komandë zanore, të tillë si «Elona celular».
- 4 Ndiqni udhëzimet e afishuara. Prisni të dëgjoni tonin dhe shqiptojeni komandën për t'u regjistruar. Komanda zanore do t'ju riprodhohet.
- 5 Nëse regjistrimi ju pëlqen, përzgjidhni **Po**. Përndryshe, përzgjidhni **Jo** dhe përsërisni etapat 3 dhe 4.

- ! *Komandat zanore mund të ruhen vetëm në kujtesë të telefonit. Nuk mund t'i përdorni në telefon tjetër.*

### *Për të kryer telefonim zanor*

- 1 Nga gatishmëria, mbani të shtypur njërin prej tasteve të volumit.
- 2 Prisni të dëgjoni tonin dhe thoni një emër të regjistruar, për shembull «Elona celular». Telefoni do t'ju riprodhojë emrin dhe do të kryejë telefonatën.

### *Përgjigja zanore*

Kur përdorni një sistem telefonimi pa duar, telefonatave në hyrje mund t'u përgjigjeni ose t'i refuzoni me zë.

### *Për të aktivizuar përgjigjen zanore dhe për të regjistruar komanda të përgjigjes zanore*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Të përgjithshme** > **Komandimi zanor** > **Përgjigje zanore** > **Aktivizoje**.
- 2 Ndiqni udhëzimet që afishohen dhe përzgjidhni **Vazhdo**. Prisni të dëgjoni tonin dhe thoni «Përgjigju» ose ndonjë fjalë tjetër çfarëdo.
- 3 Përzgjidhni **Po** për të pranuar ose **Jo** për një regjistrim të ri.

- 4 Ndiqni udhëzimet që afishohen dhe përzgjidhni **Vazhdo**. Prisi të dëgjoni tonin dhe thoni «I zënë» ose ndonjë fjalë tjetër çfarëdo.
- 5 Përzgjidhni **Po** për të pranuar ose **Jo** për një regjistrim të ri.
- 6 Ndiqni udhëzimet që afishohen dhe përzgjidhni **Vazhdo**.
- 7 Përzgjidhni mjediset ku dëshironi të aktivizoni përgjigjen zanore.

*Për t'iu përgjigjur një telefonate me anë të komandave zanore*

- Thoni «Përgjigju».

*Për ta refuzuar një telefonatë me anë të komandave zanore*

- Thoni «I zënë».



### Devijimi i telefonatave

Telefonatat mund t'i devijoni drejt, për shembull, një mesazherie.



*Kur përdorni funksionin **Blloko telefonata**, disa shtesa të devijimit nuk mund të përdoren. Shihni **Bllokimi i telefonimit** në f. 39.*

### Për të devijuar telefonata

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Telefonatat** > **Devijo telefonat**.
- 2 Përzgjidhni llojin e telefonatës dhe një mundësi shtesë devijimi.

- 3 Përzgjidhni **Aktivizoje**.
- 4 Futni numrin ku do t'i devijoni telefonatat dhe përzgjidhni **OK**.



### Disa telefonata njëkohësisht

Mund të trajtoni më shumë se një telefonatë njëkohësisht. Për shembull, mund ta vini telefonatën në pritje, kur bëni ose i përgjigjeni një telefonate të dytë. Mund edhe të këmbeheni midis dy telefonatave. Nuk mund t'i përgjigjeni një telefonate të tretë pa përfunduar një nga dy të parat. Mund edhe të bashkoni dy telefonata.

### Telefonata në ardhje

Kur përdorni shërbimin e telefonatës në ardhje, do të dëgjoni një bip kur t'ju mbërrijë një telefonatë e dytë.


### Për të aktivizuar shërbimin e telefonatës në ardhje

- Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Telefonatat** > **Trajto telefonatat** > **Telef. në ardhje** > **Aktivizoje**.


### Për të bërë një telefonatë të dytë

- 1 Gjatë telefonatës, shtypni . Telefonata në vazhdim do të vihet në pritje.
- 2 Përzgjidhni **Shtesat** > **Bëj telefon. tjetër**.
- 3 Futni numrin të cilit dëshironi t'i telefononi dhe shtypni .

### *Për t'iu përgjigjur një telefonate të dytë*

- Gjatë telefonatës, shtypni  .  
Telefonata në vazhdim do të vihet në pritje.

### *Për të refuzuar një telefonatë të dytë*

- Gjatë telefonatës, shtypni  dhe vazhdoni me telefonatën e parë.


### *Për të përfunduar një telefonatë në vazhdim dhe për t'iu përgjigjur një telefonate të dytë.*

- Gjatë telefonatës, përzgjidhni **Zvnds.** **telef.aktive.**

### *Për të trajtuar dy telefonata zanore*

Mund të keni telefonata në vazhdim dhe në pritje, njëkohësisht.

### *Për t'u këmbyer midis dy telefonatave*

- Gjatë telefonatës, shtypni  .

### *Për të bashkuar dy telefonata*



- Gjatë telefonatës, përzgjidhni **Shtesat** > **Bashkoi telef.**



### *Për të lidhur dy telefonata*

- Gjatë telefonatës, përzgjidhni **Shtesat** > **Transfero telef.** Ju vetë do të shkëputeni si nga njëra ashtu edhe nga tjetra.

### *Për të përfunduar një telefonatë në vazhdim dhe për t'iu kthyer tek telefonata në pritje*



- Shtypni më parë  pastaj  .



### *Konferencat*

Gjatë një telefonate konferencë mund të zhvilloni një bisedë të përbashkët me deri pesë vetë njëkohësisht.

### *Për të shtuar një pjesëmarrës të ri*

- 1 Gjatë telefonatës, shtypni  . Kjo do t'i vërë telefonatat e bashkuara në pritje.
- 2 Përzgjidhni **Shtesat** > **Bëj telefon. tjetër.**
- 3 Futeni numrin të cilit dëshironi t'i telefononi dhe shtypni  .
- 4 Përzgjidhni **Shtesat** > **Bashkoi telef.** për të shtuar pjesëmarrësin e ri.
- 5 Përsëriteni këtë veprim për të shtuar pjesëmarrës të tjerë.

### *Për të liruar një pjesëmarrës*

- 1 Përzgjidhni **Shtesat** > **Liroje palën.**
- 2 Përzgjidhni pjesëmarrësin që do të lironi.

### *Për të kryer një bisedë private*

- 1 Gjatë telefonatës, përzgjidhni **Shtesat** > **Fol me** dhe përzgjidhni pjesëmarrësin me të cilin do të flisni.
- 2 Për t'iu kthyer në konferencë, përzgjidhni **Shtesat** > **Bashkoi telef.**



## Numrat e mi

Numrat tuaj të telefonit mund t'i shihni, t'i ndryshoni ose t'u shtoni të tjerë.

### *Për të kontrolluar numrat tuaj të telefonit*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Kontaktet**.
- 2 Shkoni te **Kontakt i ri** dhe përzgjidhni **Shtesa** > **Numra specialë** > **Numrat e mi**.
- 3 Përzgjidhni një mundësi shtesë.

## Pranimi i telefonatave

Mund të vendosni të merrni telefonata vetëm nga disa numra telefoni të caktuar.

### *Për t'i shtuar numra listës së telefonuesve të pranuar*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Telefonatat** > **Trajto telefonatat** > **Pranimi telefonatash** > **Vetëm nga lista**.
- 2 Shkoni te **I ri** dhe përzgjidhni **Shto**.
- 3 Përzgjidhni një kontakt, ose **Grupet**.

 *Shihni Grupet në f. 34.*

### *Për t'i pranuar të gjitha telefonatat*

- Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Telefonatat** > **Trajto telefonatat** > **Pranimi telefonatash** > **Gjith telefonuesit**.



## Bllokimi i telefonimit

Mund të bllokoni telefonatat në hyrje dhe në dalje. Për këtë ju duhet një fjalëkalim nga ofruesi i shërbimit.



*Në rast se i devijoni telefonatat në hyrje, nuk mund t'i përdorni disa mundësi shtesë të bllokimit të telefonatave.*

## Mundësi shtesë të bllokimit të telefonatave

Mundësitë shtesë standard janë:

- **Të gjitha në dalje** – të gjitha telefonatat në dalje.
- **Ndërk. në dalje** – të gjitha telefonatat ndërkombëtare në dalje.
- **Ndkmb.dalje. roam.** – të gjitha telefonatat ndërkombëtare në dalje me përjashtim të atyre në vendin tuaj.
- **Të gjitha në hyrje** – të gjitha telefonatat në hyrje.
- **Edhe kur roaming** – të gjitha telefonatat në hyrje kur jeni jashtë shtetit.

### *Për të bllokuar telefonatat*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Telefonatat** > **Trajto telefonatat** > **Blloko telefonata**.
- 2 Përzgjidhni një mundësi shtesë.
- 3 Përzgjidhni **Aktivizoje**.
- 4 Futni fjalëkalimin dhe përzgjidhni **OK**.



## Telefonimi fiks

Telefonimi fiks lejon që t'u telefonohet vetëm disa numrave të caktuar, që ruhen në kartën SIM. Numrat fiks mbrohen me kodin PIN2.

Mund të ruani edhe numra të pjesshëm. Për shembull, po të ruani 0123456 do të mund t'i telefononi çdo numri që nis me 0123456.



*Kur përdorni telefonimin fiks, nuk mund të shihni ose të administroni numra telefoni që ruhen në kartën SIM, por gjithnjë mund t'i telefononi numrit ndërkombëtar të urgjencës, 112.*

### Për të përdorur telefonimin fiks

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Kontaktet**.
- 2 Shkoni te **Kontakt i ri** dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Numra specialë** > **Telefonimi fiks** > **Aktivizojë**.
- 3 Futni kodin PIN2 dhe përzgjidhni **OK**.
- 4 Përzgjidhni **OK** përsëri për të konfirmuar.

### Për të ruajtur një numër fiks

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Kontaktet**.
- 2 Shkoni te **Kontakt i ri** dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Numra specialë** > **Telefonimi fiks** > **Numrat fiks** > **Numër i ri**.
- 3 Futni të dhënat dhe përzgjidhni **Ruaje**.



## Kohëzgjatja dhe kostoja e telefonatave

Gjatë një telefonate, telefoni do të afishojë kohëzgjatjen. Mund edhe të shihni kohëzgjatjen e telefonatës së fundit, telefonatave në dalje dhe kohëzgjatjen gjithsej të telefonatave.

### Për të kontrolluar kohëzgjatjen

- Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Telefonatat** > **Kohëzgjatja & Kosto** > **Kohëmatësit**.



## Për ta treguar ose fshehur numrin tuaj

Kur bëni një telefonatë, numrin tuaj të telefonit mund të vendosni ta tregoni ose ta mbani të fshehtë.

### Për ta fshehur numrin e telefonit

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Telefonatat** > **Afsho/fshihe num**.
- 2 Përzgjidhni **Fshihe numrin**.

# Mesazhimi

## Për të marrë dhe ruajtur mesazhe

Kur ju mbërrin një mesazh, do të njoftoheni. Mesazhet ruhen automatikisht në kujtesën e telefonit. Kur të mos ketë më vend në kujtesë të telefonit, do t'ju duhet të fshini mesazhe ose t'i ruani në kartën SIM.

## Për të ruajtur një mesazh në një kartë kujtese

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **Cilësimet** > **Të përgjithshme** > **Ruaje në** > **Karta e kujtesës**.

## Për ta ruajtur një mesazh në kartën SIM

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** dhe përzgjidhni një regjistër.
- 2 Shkoni te një mesazh dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Ruaje mesazhin**.

## Për të parë një mesazh nga kutia në hyrje

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **Kutia në hyrje**.
- 2 Shkoni te mesazhi dhe përzgjidhni **Shih**.

## Mesazhet shkrimore

Mesazhet shkrimore mund të përmbajnë edhe foto të thjeshta, efekte zanore, animacione dhe melodi.

## Për të shkruar dhe dërguar një mesazh shkrimor

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **Krijë të ri** > **Mesazh shkrimor**.
- 2 Shkruajeni mesazhin dhe përzgjidhni **Vazhdo** > **Gjeje në Kontaktet**.
- 3 Përzgjidhni një marrës dhe përzgjidhni **Dërgoje**.



Nëse i dërgoni mesazh shkrimor një grupi, do të faturoheni veçmas për secilin pjesëtar të grupit. Shihni Grupet në f. 34.

## Për të kopjuar dhe ngjitur tekst në një mesazh shkrimor

- 1 Kur shkruani mesazhin, përzgjidhni **Shtesat** > **Kopjo & ngjit**.
- 2 Përzgjidhni **Kopjo të gjitha** ose **Shenjo & kopjo**. Shenjoheni tekstin në mesazh.
- 3 Përzgjidhni **Shtesat** > **Kopjo & ngjit** > **Ngjite**.

## Për t'i shtuar një objekt mesazhit shkrimor

- 1 Kur shkruani mesazhin, përzgjidhni **Shtesat** > **Shto objekt**.
- 2 Përzgjidhni një mundësi shtesë dhe një objekt për të shtuar.

## Për t'i telefonuar një numri në një mesazh shkrimor

- Kur po e shihni mesazhin, shkoni te numri i telefonit dhe shtypni

## ***Për t'i aktivizuar mesazhet e gjata***



- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **Cilësimet** > **Mesazh shkrimor**.
- 2 Përzgjidhni **Gjat.max.mesazhit** > **Max. i përdorsh**.

## **Mesazhet-figurë**

Mesazhet-figurë mund të përmbajnë tekst, figura, faqe diapozitiva, regjistruime zanore, videoklipe, firma dhe shtojca. Mesazhe-figurë mund t'i dërgoni një telefoni celular ose një adrese PE.

- ! *Për të dërguar një mesazh figurë, duhet të keni cilësimet e duhura në telefon. Nëse nuk i përdorni dot mesazhet-figurë, shihni Mënjanimi i problemeve në f. 69.*

## ***Për të krijuar dhe për të dërguar një mesazh-figurë***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **Krijo të ri** > **Mesazh-figurë**.
- 2 Futni tekst. Për t'i shtuar objekte mesazhit, shtypni , lundroni me  dhe përzgjidhni një objekt.
- 3 Përzgjidhni **Vazhdo** > **Gjeje në Kontaktet**.
- 4 Përzgjidhni një marrës dhe përzgjidhni **Dërgoje**.

**Për të marrë mesazhe-figurë**  
Mund të vendosni si do t'i shkarkoni mesazhet-figurë. Kur shkarkoni mesazhe-figurë mund të zgjidhni midis këtyre mundësive shtesë standard:

- **Gjithnjë** – shkarkim automatik.
- **Pyet kur roam**. – telefoni kërkon leje për të shkarkuar, kur nuk jeni në rrjetin bazë.
- **Kurrë kur roam**. – asnjë shkarkim nuk do të kryhet, kur nuk jeni në rrjetin bazë.
- **Gjithnjë pyet** – telefoni kërkon leje për të shkarkuar.
- **Çaktivizoje** – mesazhet e reja do të afishohen në **Kutia në hyrje**.

## ***Për të cilësuar shkarkimin automatik***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **Cilësimet** > **Mesazh-figurë** > **Vetëshkarkimi**.
- 2 Përzgjidhni një mundësi shtesë.

## **Mundësitë shtesë të mesazheve**

Mund të cilësoni mundësi shtesa standard për të gjitha mesazhet, ose të zgjidhni cilësime specifike sa herë që dërgoni një mesazh.

### *Për të cilësuar mundësi shtesë të mesazhimit shkrimor*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **Cilësimet** > **Mesazh shkrimor**.
- 2 Shkoni te një mundësi shtesë dhe përzgjidhni **Ndrysh**.

### *Për të cilësuar mundësi shtesë të mesazhimit-figurë*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **Cilësimet** > **Mesazh-figurë**.
- 2 Shkoni te një mundësi shtesë dhe përzgjidhni **Ndrysh**.

### *Për të cilësuar mundësi shtesë për një mesazh të caktuar*

- 1 Kur mesazhi të jetë gati dhe të keni cilësuar një marrës, përzgjidhni **Shtesat** > **Të avancuara**.
- 2 Shkoni te një mundësi shtesë dhe përzgjidhni **Ndrysh**.

## **Modelet**



Nëse ju qëllon të përdorni shpesh po ato fraza dhe figura në një mesazh, mund ta ruani mesazhin si model.

### *Për të shtuar një model mesazhi shkrimor*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **Modelet** > **Model i ri** > **Tekst**.

- 2 Futni tekst ose përzgjidhni **Shtesat** për të shtuar objekte. Përzgjidhni **OK**.
- 3 Vërinë një titull dhe përzgjidhni **OK**.

### *Për të shtuar një model mesazhi-figurë*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **Modelet** > **Model i ri** > **Mesazh-figurë**.
- 2 Futni tekst. Për t'i shtuar objekte mesazhit, shtypni , lundroni me  dhe përzgjidhni një objekt.
- 3 Përzgjidhni **Ruaje**, vërinë një titull dhe përzgjidhni **OK**.

### *Për ta ruajtur një mesazh si model*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **Kutia në hyrje**.
- 2 Shkoni te mesazhi dhe përzgjidhni **Shih** > **Shtesat** > **Ruaje si model**.



## **Mesazhet zanore**

Mund të dërgoni dhe të merrni një regjistrim zanor në trajtë të një mesazhi zanor.



*Dërguesi dhe marrësi duhet të kenë pajtimtari të tillë që ta përballojë mesazhimin-figurë.*

## ***Për të regjistruar dhe për të dërguar një mesazh zazor***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **Krijo të ri** > **Mesazh zazor**.
- 2 Regjistrojeni mesazhin dhe përzgjidhni **Stop** > **Dërgoje** > **Gjeje në Kontaktet**.
- 3 Përzgjidhni një marrës dhe përzgjidhni **Dërgoje**.



## **Posta elektronike**

Në telefon mund të përdorni funksione standard të postës elektronike dhe adresën PE që përdorni edhe në kompjuter.



*Mund ta sinkronizoni postën tuaj elektronike me anë të shërbimit Microsoft® Exchange ActiveSync.*

### **Para se të përdorni postën elektronike**

Mund të doni të kontrolloni, me anë të udhëzorit të konfigurimit, nëse telefoni i ka cilësimet për llogarinë tuaj PE, ose mund t'i futni këto cilësime ju vetë. Cilësimet mund edhe t'i merrni në [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support).

### ***Për të krijuar një llogari PE***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **PE** > **Llogaritë**.
- 2 Shkoni te **Llogari e re** dhe përzgjidhni **Shto**.



*Po t'i futni cilësimet ju vetë, mund t'i kërkonti të dhëna të mëtejshme ofruesit të shërbimit PE. Ofrues i shërbimit PE mund të jetë kompania që ju ka dhënë adresën tuaj PE.*

### ***Për të shkruar dhe dërguar një mesazh PE***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **PE** > **Krijo të ri**.
- 2 Përzgjidhni **Shto** > **Fut adresën PE**. Futni adresën PE dhe përzgjidhni **OK**.
- 3 Për të shtuar marrës, shkoni te **Merr:** dhe përzgjidhni **Ndryshoje**.
- 4 Shkoni te një mundësi shtesë dhe përzgjidhni **Shto** > **Fut adresën PE**. Futni adresën PE dhe përzgjidhni **OK**. Kur të jeni gati, përzgjidhni **Mbarova**.
- 5 Përzgjidhni **Ndryshoje** dhe futni një subjekt. Përzgjidhni **OK**.
- 6 Përzgjidhni **Ndryshoje** dhe futni tekstin. Përzgjidhni **OK**.
- 7 Përzgjidhni **Shto** dhe zgjidhni një skedë për të bashkëlidhur.
- 8 Përzgjidhni **Vazhdo** > **Dërgoje**.

### ***Për të marrë dhe lexuar një mesazh PE***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **PE** > **Kutia në hyrje** > **Shtesat** > **Posta e re**.
- 2 Shkoni te mesazhi dhe përzgjidhni **Shih**.

### ***Për të ruajtur një mesazh PE***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **PE** > **Kutia në hyrje**.
- 2 Shkoni te mesazhi dhe përzgjidhni **Shih** > **Shtesat** > **Ruaje mesazhin**.

### ***Për t'iu përgjigjur një mesazhi PE***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **PE** > **Kutia në hyrje**.
- 2 Shkoni te mesazhi dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Përgjigju**.
- 3 Shkruajeni përgjigjen dhe përzgjidhni **OK**.
- 4 Përzgjidhni **Vazhdo** > **Dërgoje**.

### ***Për të parë një shtojcë në një mesazh PE***

- Kur po e shihni mesazhin, përzgjidhni **Shtesat** > **Shtojcat** > **Përdore** > **Shih**.

### ***Për të ruajtur një shtojcë që ju ka ardhur me mesazhin PE***

- Kur po e shihni mesazhin, përzgjidhni **Shtesat** > **Shtojcat** > **Përdore** > **Ruaje**.

### **Llogaria PE aktive**

Po të keni disa llogari PE, mund ta cilësoni vetë llogarinë aktive.

### ***Për ta ndryshuar llogarinë PE aktive***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **PE** > **Llogaritë**.
- 2 Përzgjidhni një llogari.

### **PE Push**

Mund të dëshironi që serveri PE t'ju dërgojë njoftim në telefon sa herë që të keni mesazhe të reja PE.

### ***Për ta aktivizuar njoftimin PE push***

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **PE** > **Cilësimet** > **PE** njoftuese «Push».

### **Shokët e mi**

Mund të lidheni me serverin Shokët e mi dhe të futeni atje për të komunikuar në linjë me mesazhe chat.

Nëse nuk e përdorni dot Shokët e mi, shihni *Mënjanimi i problemeve* në f. 69.

### **Para se të përdorni shërbimin Shokët e mi**

Po të mos i keni cilësimet në telefon, duhet të futni cilësimet e serverit.

Ofruesi i shërbimit mund t'ju japë të dhëna standard për cilësimet, të tilla si:

- Emri i përdoruesit
- Fjalëkalimi
- Adresa e serverit
- Profili për Internet

### ***Për të futur cilësimet e serverit Shokët e mi***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **Shokët e mi** > **Konfiguro**.
- 2 Shkoni te një cilësim dhe përzgjidhni **Shto**.

### ***Për t'u futur me login në serverin Shokët e mi***

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **Shokët e mi** > **Lidhu**.

### ***Për të dalë me logout nga serveri Shokët e mi***

- Përzgjidhni **Shtesat** > **Shkëputu**.

### ***Për të shtuar një kontakt chat***

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **Shokët e mi** > kartela **Kontaktet**.
- 2 Përzgjidhni **Shtesat** > **Shto kontakt**.

### ***Për të dërguar një mesazh chat***

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **Shokët e mi** > kartela **Kontaktet**.
- 2 Shkoni te një kontakt dhe përzgjidhni **Chat**.
- 3 Shkruajeni mesazhin dhe përzgjidhni **Dërgoje**.

### **Statusi**

Mund të afishoni statusin, për shembull, **I lumtur** ose **I zënë**, për kontaktet tuaja vetëm. Mund edhe të vendosni t'ua tregoni statusin të gjithë përdoruesve në serverin **Shokët e mi**.

### ***Për të treguar statusin***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **Shokët e mi** > **Shtesat** > **Cilësimet** > **Trgo gjendjen time**.
- 2 Përzgjidhni një mundësi shtesë.

### ***Për ta përditësuar statusin***

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **Shokët e mi** > kartela **Gjendja ime**.
- 2 Ndryshojini të dhënat.
- 3 Përzgjidhni **Shtesat** > **Ruaje**.

### **Grupi chat**

Grupin chat mund ta krijojë ofruesi i shërbimit, një përdorues individual i serverit **Shokët e mi**, ose ju vetë. Grupet chat mund t'i ruani duke ruajtur ftesa për chat, ose duke kërkuar për një grup chat të caktuar.

### ***Për të krijuar një grup chat***

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **Shokët e mi** > kartela **Grupe chat**.
- 2 Përzgjidhni **Shtesat** > **Shto grup chat** > **Grup i ri chat**.
- 3 Vendosni se kë do të ftoni nga lista e kontakteve dhe përzgjidhni **Vazhdo**.
- 4 Futni një tekst të shkurtër për ftesën dhe përzgjidhni **Vazhdo** > **Dërgoje**.



### *Për të shtuar një grup chat*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **Shokët e mi** > kartela **Grupe chat** > **Shtesat** > **Shto grup chat**.
- 2 Përzgjidhni një mundësi shtesë.

! *Historia e bisedës do të ruhet pasi të dilni me logout, në mënyrë që kur të ktheheni në chat, mund ta vazhdoni aty ku e keni ndërprerë.*

### *Për të ruajtur një bisedë*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **Shokët e mi** > kartela **Biseda**.
- 2 Futuni në një bisedë.
- 3 Përzgjidhni **Shtesat** > **Të avancuara** > **Ruaje bisedën**.

### **Informacioni zonal dhe celular**

Mesazhet e informacionit zonal dhe celular janë mesazhe shkrimore, për shembull, të dhëna për trafikun lokal, që u dërgohen pajtimtarëve brenda një zone të caktuar të rrejtit nga ofruesi i shërbimit, nëse këta i kanë kërkuar.


### *Për ta aktivizuar informacionin zonal*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Mesazhimi** > **Cilësimet** > **Info zonale**.
- 2 Shkoni te **Marrja** dhe përzgjidhni **Ndrysh.** > **Aktiv.**

## Trajtimi i imazhit

Fotot që nxirri ose videot që regjistroni mund t'i shihni, t'i ruani ose t'ua dërgoni të tjerëve. Kur regjistroni video, mund të përdorni dritën. Fotot dhe videoklipet që keni ruajtur do t'i gjeni në **Media** dhe në **Skedari**.


### Tastet e pamorit dhe të kamerës



- 1 Përdorni zoom zmadhues ose zvogëlues
- 2 Nxirri foto/regjistroni videoklipe

### Si përdoret kamera


#### *Për ta ndezur kameran*

- Nga gatishmëria, shtypni pak çaste .



## Drita për foto

Dritën për foto mund ta përdorni për të përmirësuar kushtet e ndriçimit.




### Për ta ndezur Dritën për foto


- Ndizeni kameran dhe përzgjidhni  > **Ndriçimi**.

### Për të nxjerrë një foto

- 1 Ndizeni kameran dhe shtypni tastin e lundrimit lart ose poshtë, për të shkuar te .
- 2 Shtypni  për të nxjerrë foton.
- 3 Fotoja do të ruhet automatikisht.


### Për të regjistruar një videoklip

- 1 Ndizeni kameran dhe shtypni tastin e lundrimit lart ose poshtë, për të shkuar te .
- 2 Shtypni  për të nisur regjistrimin.
- 3 Për të ndalur regjistrimin, shtypni . Videoklipi do të ruhet automatikisht.

 *Mos nxirrni fotografi me një burim të fortë drite në sfond. Përdorni një suport, ose vetë-kohëmatësin, që fotoja të mos dalë e shfokusuar.*

### Për të përdorur zoom-in


- Shtypni tastin e volumit lart ose poshtë.

 *Kur po nxirrni një foto, zoom-in mund ta përdorni vetëm në VGA.*

## Për të ndrequr ndriçimin

- Shtypni tastin e lundrimit majtas ose djathtas.

### Për t'i parë fotot

- 1 Ndizeni kameran dhe përzgjidhni .
- 2 Shkoni te objekti që ju intereson.


## Funksione të tjera të kameras

Me Ndreqe foton mund edhe të përmirësoni një foto të paeksponuar mirë.

### Ikonat dhe cilësimet e kameras

Ikonat në ekran tregojnë se çfarë cilësimi po përdoret. Cilësimet e tjera të kameras gjenden në **Shtesat**.







### Për të ndryshuar cilësimet

- Ndizeni kameran dhe përzgjidhni .

### Për të parë të dhëna për cilësimet

- Shkoni te një cilësim dhe përzgjidhni .

### Shkurtoret e kameras

Tasti	Shkurtoerja
	Zoom zvogëlues
	Zoom zmadhues
	Kamera: <b>Mënyra e të nxjerrit</b> Video: <b>Kohëzgjatja e videos</b>
	<b>Vetë-kohëmatësi</b>
	<b>Natën</b>
	Udhëzues për tastet e kameras


## Për të parë dhe etiketuar fotot

Fotot mund t'i shihni dhe t'i etiketoni në [Media](#).

### *Për t'i parë fotot si paradë diapozitivash*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni [Menuja](#) > [Media](#) > [Foto](#) > [Album kamera](#).
- 2 Përzgjidhni një muaj.
- 3 Shkoni te një foto dhe përzgjidhni [Shih](#).
- 4 Përzgjidhni [Shtesat](#) > [Paradë diapoz.](#)
- 5 Përzgjidhni një profil.


### *Për t'i parë fotot në hartë*

Po të afishohet  në ekran, pozicioni juaj gjeografik do të ruhet së bashku me fotot që nxirrni. Ky quhet etiketim gjeografik dhe tregon me përafërsi vendin se ku është nxjerrë fotoja.

### *Për t'i parë fotot në hartë*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni [Menuja](#) > [Media](#) > [Foto](#) > [Album kamera](#).
- 2 Përzgjidhni një muaj.
- 3 Shkoni te një foto dhe përzgjidhni [Shih](#).
- 4 Përzgjidhni [Shtesat](#) > [Shihe në hartë](#).


### *Për të ndryshuar cilësimet e etiketimit gjeografik*

- 1 Ndizeni kameran dhe përzgjidhni .
- 2 Shkoni te [Cilësimet](#) > [Shto pozicion](#).


## Etiketat e fotove

Fotove mund t'u vini etiketa, për t'i kategorizuar në [Etiketa fotosh](#). Për shembull, mund të krijoni një etiketë për pushimet verore, dhe t'ua shtoni të gjitha fotove që keni nxjerrë kur keni qenë me pushime.

### *Për të krijuar një etiketë të re fotosh*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni [Menuja](#) > [Media](#) > [Foto](#) > [Album kamera](#).
- 2 Përzgjidhni një muaj.
- 3 Shkoni te një foto dhe përzgjidhni [Shih](#).
- 4 Shtypni  dhe përzgjidhni [Shtesat](#) > [Etiketë e re](#).
- 5 Futni një emër dhe përzgjidhni [OK](#).
- 6 Përzgjidhni një ikonë.
- 7 Shtypni tastin funksional qendror, për ta etiketuar foton.

### *Për t'i etiketuar fotot*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni [Menuja](#) > [Media](#) > [Foto](#) > [Album kamera](#).
- 2 Përzgjidhni një muaj.
- 3 Shkoni te një foto dhe përzgjidhni [Shih](#).
- 4 Shtypni  dhe shkoni te një etiketë.
- 5 Shtypni tastin funksional qendror.
- 6 Sa herë që dëshironi të etiketoni një foto, shkoni te fotoja dhe shtypni tastin funksional qendror.

## Çfarë mund të bëni me fotot

Mund t'ia shtoni një foto një kontakti, ta përdorni si ekran përshëndetës në ndezje, si sfond në gatishmëri, ose si ekran-ruajtëse.

### *Për të përdorur fotot*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Media** > **Foto** > **Album kamera**.
- 2 Përzgjidhni një muaj.
- 3 Shkoni te një foto dhe përzgjidhni **Shih**.
- 4 Përzgjidhni **Shtesat** > **Përdore si**.
- 5 Përzgjidhni një mundësi shtesë.

### *Për të cilësuar një aplikacion Java™ si sfond*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Ekrani**.
- 2 Përzgjidhni **Sfondi** > **Aplikacion**.
- 3 Përzgjidhni një aplikacion Java.

! Do të shihni vetëm ato aplikacione Java™ që mund të përdoren si sfond.

## Çfarë mund të bëni me fotot

Fotot dhe videoklipet mund t'i shihni, t'i përpunoni dhe t'i organizoni në kompjuter, duke instaluar programin *Adobe™ Photoshop™ Album Starter Edition*. Këtë program do ta gjeni në CD-në që ju vjen me telefonin, ose mund ta shkarkoni nga [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support).

Përdorni *Sony Ericsson Media Manager* për të shkëmbyer materiale me telefonin. *Shihni Për të shkëmbyer materiale me një kompjuter* në f. 24 për të dhëna të mëtejshme.

### **PhotoDJ™ dhe VideoDJ™**

Fotot dhe videoklipet mund t'i përpunoni.

### *Për të përpunuar dhe ruajtur një foto*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Media** > **Foto** > **Album kamera**.
- 2 Përzgjidhni një muaj.
- 3 Shkoni te një foto dhe përzgjidhni **Shih**.
- 4 Përzgjidhni **Shtesat** > **Me PhotoDJ™**.
- 5 Përpunojeni foton.
- 6 Përzgjidhni **Shtesat** > **Ruaje foton**.

### *Për të përpunuar dhe ruajtur një videoklip*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Organizuesi** > **Skedari** > **Album kamera**.
- 2 Shkoni te një videoklip dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Me VideoDJ™**.
- 3 Përpunojeni videoklipin.
- 4 Përzgjidhni **Shtesat** > **Ruaje**.

### *Për të krasitur një videoklip*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Organizuesi** > **Skedari** > **Album kamera**.

- 2 Shkoni te një videoklip dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Me VideoDJ™** > **Ndrysh.** > **Krasite.**
- 3 Përzgjidhni **Cilësoje** për të cilësuar pikënisjen dhe përzgjidhni **Fillimi.**
- 4 Përzgjidhni **Cilësoje** për të cilësuar pikëmbarimin dhe përzgjidhni **Fund.**
- 5 Përzgjidhni **Krasite** > **Shtesat** > **Ruaje.**

## Blogimi

Blogu është një faqe Interneti personale, ku mund të dërgoni foto dhe videoklipe për t'ua treguar të tjerëve. Në qoftë se pajtimtaria juaj e përballon këtë shërbim, mund t'i dërgoni fotot ose videoklipet në blog.

Nëse nuk e përdorni dot fotoblogun ose videoblogun, shihni *Mënjanimi i problemeve* në f. 69.

- ! *Shërbimet në Internet mund të kërkojnë një marrëveshje të posaçme licensimi midis jush dhe ofruesit të shërbimit. Mund të zbatohen edhe rregullore dhe tarifa të tjera. Informohuni më tej pranë ofruesit të shërbimit.*

### ***Për t'i dërguar një blogu foto të kamerës***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Media** > **Foto** > **Album kamera.**
- 2 Përzgjidhni një muaj.

- 3 Shkoni te një foto dhe përzgjidhni **Shih.**
- 4 Përzgjidhni **Shtesat** > **Dërgoje** > **Blogut.**
- 5 Futni titull dhe tekst, pastaj përzgjidhni **OK.**
- 6 Përzgjidhni **Botoje.**

- 💡 *Mund edhe t'i dërgoni një foto blogut sapo ta keni nxjerrë, duke përzgjedhur **Dërgoje** > **Blogut.***

### ***Për t'i dërguar një blogu videoklipe***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Media** > **Video.**
- 2 Shkoni te një videoklip dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Dërgoje** > **Blogut.**
- 3 Futni titull dhe tekst, pastaj përzgjidhni **OK.**
- 4 Përzgjidhni **Botoje.**

- 💡 *Mund edhe t'i dërgoni një videoklip blogut sapo ta keni regjistruar, duke përzgjedhur **Dërgoje** > **Blogut.***

### ***Për të shkuar te një adresë blogu nga kontaktet***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Kontaktet.**
- 2 Shkoni te një kontakt dhe përzgjidhni një adresë Interneti.
- 3 Përzgjidhni **Shko te.**

## Printimi i fotove

Mund të printoni foto të kamerës duke lidhur kabllon USB me një printer të pajtueshëm.

- *Mund edhe të printoni me anë të një printeri Bluetooth të pajtueshëm, që përballon profilin Push Objekt.*

### ***Për të printuar foto të kamerës me anë të kabllon USB***

- 1 Lidhni kabllon USB me telefonin.
- 2 Lidhni kabllon USB me printerin.
- 3 Prisni për konfirmim në telefon dhe përzgjidhni **OK**.
- 4 Futni cilësime të printerit (nëse ju kërkohen), dhe përzgjidhni **Printo**.
- 5 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja > Media > Foto > Album kamera**.
- 6 Përzgjidhni një muaj.
- 7 Shkoni te një foto dhe përzgjidhni **Shtesat > Printo**.

- *Po të ketë gabim të printerit, duhet ta shkëputni dhe riliidhni kabllon USB.*

## Interneti

Nëse nuk e përdorni dot Internetin, shihni *Mënjanimi i problemeve* në f. 69.

### ***Për të filluar shfletimin***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja > Internet**.
- 2 Përzgjidhni **Shtesat > Shko te**.
- 3 Përzgjidhni një mundësi shtesë.

### ***Për të dalë nga shfletuesi***

- Kur jeni duke shfletuar Internetin, përzgjidhni **Shtesat > Dil nga shfletuesi**.

## Kujtesoret

Mund të krijoni dhe të ndryshoni kujtesoret, për t'i përdorur si nyje të shpejta drejt faqeve tuaja të preferuara në Internet.

### ***Për të krijuar një kujtesore***

- 1 Kur jeni duke shfletuar Internetin, përzgjidhni **Shtesat > Vegla > Shto kujtesore**.
- 2 Vëri një titull dhe një adresë. Përzgjidhni **Ruaje**.

### ***Për të përzgjedhur një kujtesore***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja > Internet**.
- 2 Përzgjidhni **Shtesat > Shko te > Kujtesoret**.
- 3 Shkoni te kujtesorja dhe përzgjidhni **Shko te**.

## Faqet që keni shfletuar

Mund të shihni faqe Interneti që keni shfletuar më parë.

### *Për të parë faqe që keni shfletuar*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Internet** > **Shtesat** > **Shko te** > **Historia**.

## Funksione të tjera të shfletuesit

### *Për të përdorur efektin panoramik zmadhues në një faqe Interneti*

- 1 Kur jeni duke shfletuar Internetin, shtypni (#→↻).
- 2 Përdorni tastin e lundrimit për ta zhvendosur kornizën.
- 3 Shtypni **Zoom**.
- 4 Për t'u kthyer në panoramim, shtypni (#→↻).

- ! *Për të përdorur efektin panoramik zmadhues, duhet ta çaktivizoni Smart-fit: **Shtesat** > **Të avancuara** > **Smart-Fit** > **Joaktiv**.*

### *Për të telefonuar kur jeni duke shfletuar*

- Shtypni .

### *Për të ruajtur një foto nga një faqe Interneti*

- 1 Kur jeni duke shfletuar Internetin, përzgjidhni **Shtesat** > **Vegla** > **Ruaje foton**.
- 2 Përzgjidhni një foto.

### *Për të gjetur tekst në një faqe Interneti*

- 1 Kur jeni duke shfletuar Internetin, përzgjidhni **Shtesat** > **Vegla** > **Gjej në faqe**.
- 2 Futni tekst dhe shtypni **Gjej**.

### *Për të dërguar një nyje*

- 1 Kur jeni duke shfletuar Internetin, përzgjidhni **Shtesat** > **Vegla** > **Dërgoje nyjen**.
- 2 Përzgjidhni një mënyrë transferimi.







- ! *Sigurohuni që pajisja marrëse e përballon mënyrën e transferimit që keni përzgjedhur.*

### **Shkurtore të tastierës për Internet**

Mund të përdorni komanda tastesh për të shkuar drejtpërdrejt te një funksion i shfletuesit të Internetit.

### *Për të përzgjedhur shkurtore të tastierës për Internet*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Internet**.
- 2 Përzgjidhni **Shtesat** > **Të avancuara** > **Modusi i tastierës** > **Shkurtoret**.

Tasti	Shkurtorja
	Kujtesoret
 - 	Futni tekst për funksionet e mëposhtme: <b>Shkruaj adresën, Kërko në Internet, ose kërkoni në Kujtesoret.</b>
	Në gjithë ekranin ose Peizazh ose Ekran normal
	Zoom
	Panoramik & Zoom (kur funksioni Smart-Fit është joaktiv)

## Sigurshmëria në Internet dhe certifikatat

Telefoni juaj përballon shfletimin e sigursihem. Disa shërbime në Internet, të tilla si shërbimet bankare, kërkojnë të keni certifikata në telefon. Telefoni mund të përmbajë certifikata që në momentin e blerjes, ose mund të shkarkoni certifikata të reja.


### *Për të parë certifikatat që ruani në telefon*

- Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > **kartela Të përgjithshme** > **Sigurshmëria** > **Certifikata**.






## Burimet në Internet

Mund të pajtoheni dhe të shkarkoni materiale që përditësohen shpesh, si lajme, podkaste ose foto, duke përdorur burimet në Web.


### *Për të shtuar burime të reja për një faqe Interneti*

- Kur jeni duke shfletuar një faqe Interneti që përmban burime, (çka tregohet nga ) , përzgjidhni **Shtesat** > **Burimet Web**.
- Sa herë që doni të shtoni një burim, shkoni te burimi dhe përzgjidhni **Shenjo**.
- Përzgjidhni **Shtesat** > **Vazhdo**.


### *Për të shkarkuar material nëpërmjet burimeve*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Media** > **Burime Interneti**.
- Shkoni te një burim i përditësuar dhe përzgjidhni **Shihe** ose .
- Përzgjidhni një titull, për ta zgjeruar.
- Përzgjidhni një ikonë sipas materialit,  për të hapur një faqe Interneti,  për të shkarkuar një podkast audio,  për të shkarkuar një podkast video ose  për të shkarkuar një foto.




 Mund edhe të pajtoheni dhe të shkarkoni materiale nga burimet në një kompjuter, duke përdorur programin Sony Ericsson Media Manager. Nga kompjuteri mund t'i transferoni materialet në telefon. Shihni Për të shkëmbyer materiale me një kompjuter në f. 24.

### **Përditësimi i burimeve në Internet**

Mund t'i përditësoni burimet manualisht, ose të programoni përditësimet. Kur të ketë përditësimet,  do të afishohet në ekran.

#### ***Për të programuar përditësimet burimesh në Internet***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Media** > **Burime Interneti**.
- 2 Shkoni te një burim dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Planëzo përditësim**.
- 3 Përzgjidhni një mundësi shtesë.

 **Përditësimet e shpeshta mund t'ju kushtojnë.**

#### ***Për t'i përditësuar burimet manualisht***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Media** > **Burime Interneti**.
- 2 Shkoni te një burim dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Përditëso**.
- 3 Përzgjidhni një mundësi shtesë.



#### **Burimet në gatishmëri**

Në ekranin e gatishmërisë mund të afishoni lajme të përditësuara.

#### ***Për t'i afishuar burimet në gatishmëri***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Media** > **Burime Interneti**.
- 2 Shkoni te një burim dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Cilësime përgj.** > **Teleshkrues gatishm.** > **Afsho në gatishmëri**.

#### ***Për të shkuar te burimet nga gatishmëria***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Teleshk.**
- 2 Për të lexuar më shumë nga një burim, shtypni  ose  për të shkuar te një titull dhe përzgjidhni **Shko te**.

## Podkastet

Podkastet janë skeda, p.sh. programe radio ose materiale video, të cilat mund t'i shkarkoni dhe t'i riprodhoni. Mund të pajtoheni dhe të shkarkoni podkaste nëpërmjet burimeve në Web.

### *Për t'i përdorur podkastet*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Media** > **Muzikë** > **Podkastet**.

### *Për t'i përdorur podkastet video*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Media** > **Video** > **Podkastet**.

## Burimet e fotove

Mund të pajtoheni në burime fotosh dhe të shkarkoni foto. Për të filluar të përdorni burimet e fotove, shihni *Burimet në Internet* në f. 54.

### *Për të përdorur burimet e fotove*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Media** > **Foto** > **Burime fotosh**.

## Sinkronizimi

Ka dy mënyra të ndryshme për të sinkronizuar. Telefonin mund ta sinkronizoni me anë të një programi kompjuterik, ose duke përdorur një shërbim në Internet.



*Për të sinkronizuar, mos përdorni më shumë se një mënyrë njëherësh.*

Për të dhëna të mëtejshme për sinkronizimin, shkoni te [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support) për të lexuar udhëzuesit Getting started (Për të filluar).

## Sinkronizimi me anë të një kompjuteri

Mund të përdorni kabllon USB ose radioteknologjinë Bluetooth për të sinkronizuar kontakte në telefon, takime, kujtesore, detyra dhe shënime, me një program kompjuterik të tillë si Microsoft Outlook.

Para se të sinkronizoni, duhet të instaloni programin *Sony Ericsson PC Suite*.



*Sony Ericsson PC Suite do ta gjeni në CD-në që ju ka ardhur me telefonin ose mund ta shkarkoni nga [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support).*


Shihni *Sistemet operuese të nevojshme* në f. 24.

### ***Për të instaluar Sony Ericsson PC Suite***

- 1 Ndizeni kompjuterin dhe futni CD-në. CD-ja do të nisët automatikisht dhe do të hapë një dritare të instalimit.
- 2 Përzgjidhni një gjuhë dhe klikoni OK.
- 3 Klikoni mbi *Install Sony Ericsson PC suite* dhe ndiqni udhëzimet e afishuara në ekran.

### ***Për të sinkronizuar me Sony Ericsson PC Suite***

- 1 **Në kompjuter:** Niseni *PC Suite* nga *Start/Programs/Sony Ericsson/PC Suite*.
- 2 Ndiqni udhëzimet në *Sony Ericsson PC Suite* për mënyrën si duhet të lidheni.
- 3 **Në telefon:** Përzgjidhni **Modus Telefon**.
- 4 **Në kompjuter:** Kur të njoftoheni se *Sony Ericsson PC Suite* e ka gjetur telefonin, mund të filloni të sinkronizoni.

 *Për hollësi të mëtejshme, shihni seksionin e ndihmës Sony Ericsson PC Suite Help pasi ta keni instaluar programin në kompjuter.*

## **Sinkronizimi nëpërmjet një shërbimi në Internet**

Mund të sinkronizoni me një shërbim Interneti, duke përdorur SyncML™ ose një server Microsoft® Exchange Server nëpërmjet Microsoft Exchange ActiveSync. Nëse nuk sinkronizoni dot me anë të një shërbimi në Internet, shihni *Mënjanimi i problemeve* në f. 69.

### **SyncML**

Me anë të SyncML mund të sinkronizoni materiale në distancë dhe informacion personal.

### **Para se të sinkronizoni me SyncML**

Duhet të futni cilësimet për sinkronizim SyncML dhe të regjistroni një llogari sinkronizimi në linjë me një ofrues shërbimi. Do t'ju duhet:

- **Adresa e serverit** – URL-ja e serverit
- **Emri i bazës dhanore** – baza dhanore me të cilën do të sinkronizoheni

### **Për të futur cilësimet për SyncML**

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja > Organizuesi > Sinkronizimi**.
- 2 Shkoni te **Llogari e re** dhe përzgjidhni **Shto > SyncML**.
- 3 Futni një emër për llogarinë e re dhe përzgjidhni **Vazhdo**.


- 4 Përzgjidhni **Adresa e serverit**. Futni të dhënat e duhura dhe përzgjidhni **OK**.
- 5 Futni **Emri përdoruesit** dhe **Fjalëkalimi**, po t'ju kërkohet.
- 6 Shkoni te kartela **Aplikacione** dhe shenjoni aplikacionet që do të sinkronizoni.
- 7 Shkoni te kartela **Cilësimet e aplikac.** dhe përzgjidhni një aplikacion.
- 8 Përzgjidhni **Emri i bazës dhanore** dhe futni të dhënat e duhura.
- 9 Shkoni te kartela **Të avancuara** për të futur cilësimet mëtejshme për sinkronizim dhe përzgjidhni **Ruaje**.

#### ***Për të sinkronizuar me SyncML***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja > Organizuesi > Sinkronizimi**.
- 2 Shkoni te llogaria dhe përzgjidhni **Nise**.


#### **Microsoft® Exchange ActiveSync**

Mund të përdorni dhe të sinkronizoni të dhëna, të tilla si postë elektronike, kontakte dhe kryefjalë kalendari, duke përdorur Microsoft® Exchange Server me Microsoft® Exchange ActiveSync.

 *Të dhëna të mëtejshme për cilësimet e sinkronizimit mund t'ju japë administratori juaj i shërbimit informatik.*

**Para se të sinkronizoni me Microsoft® Exchange ActiveSync**  
Për të përdorur një server Microsoft Exchange Server, duhet të futni cilësimet për Microsoft Exchange ActiveSync. Do t'ju duhet:

- **Adresa e serverit** – URL-ja e serverit
- **Lëmi** – lëmi i serverit
- **Emri përdoruesit** – emri i përdoruesit të llogarisë
- **Fjalëkalimi** – fjalëkalimi i llogarisë

 *Para se të nisni të sinkronizoni me Exchange ActiveSync duhet të futni në telefon zonën orare korrekte.*

#### ***Për të futur cilësimet për Microsoft® Exchange ActiveSync***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja > Organizuesi > Sinkronizimi**.
- 2 Shkoni te **Logari e re** dhe përzgjidhni **Shtu > Exchange ActiveSync**.
- 3 Futni një emër për llogarinë e re dhe përzgjidhni **Vazhdo**.
- 4 Futni cilësimet e duhura.
- 5 Lëvizni nëpër kartela, për të futur cilësimet mëtejshme.
- 6 Përzgjidhni **Ruaje**.

#### ***Për të sinkronizuar me Microsoft® Exchange ActiveSync***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja > Organizuesi > Sinkronizimi**.
- 2 Shkoni te llogaria dhe përzgjidhni **Nise**.

## Tipare të tjera

### Profili avion

Në profilin **Avion** transmetuesit e rrejetit dhe të radios mbahen të fukur, për të mos shkaktuar interferenca me pajisje të ngjashme që përdor avioni.

Kur të aktivizohet menuja e profilit Avion, do t'ju kërkohet të përzgjidhni një profil për herën tjetër që ta ndizni telefonin:

- **Normal** – funksionalitet i plotë
- **Avion** – funksionalitet i kufizuar

### *Për të aktivizuar menunë e profilit Avion*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Të përgjithshme** > **Avion** > **Vazhdo** > **Afishoje në hapje**.

### *Për të përzgjedhur profilin Avion*

- 1 Kur të aktivizohet menuja e profilit Avion, fikenit telefonin.
- 2 Ndizeni telefonin dhe përzgjidhni **Avion**.



### **Shërbimi përditësues**

Programet që keni në telefon mund t'i përditësoni drejtpërdrejt, ose nëpërmjet një kompjuteri.

### *Për të parë programet që keni në telefon*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Të përgjithshme** > **Shërbimi përditësues**.
- 2 Përzgjidhni **Versioni progr.**

### **Shërbimi përditësues drejtpërdrejt**

Programet që keni në telefon mund t'i përditësoni drejtpërdrejt. Këtë mund ta bëni pa humbur të dhëna personale ose të telefonit.



*Shërbimi përditësues drejtpërdrejt kërkon lidhshmëri dhanore të tillë si GPRS, 3G ose HSDPA.*

### *Për të përzgjedhur cilësimet e përditësimit*

- Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Të përgjithshme** > **Shërbimi përditësues** > **Cilësimet** > **Cilësime për Internet**.

### *Për të përdorur Shërbimin përditësues drejtpërdrejt*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Të përgjithshme** > **Shërbimi përditësues**.
- 2 Përzgjidhni **Kërko përditësim** dhe ndiqni udhëzimet e afishuara.

## Shërbimi përditësues me anë të një kompjuteri

Mund ta përditësoni telefonin duke e lidhur me një kompjuter të lidhur në Internet, me anë të kabllos USB.

- ! Sigurohuni që keni bërë kopje arkivuese të të gjitha të dhënave personale që ruani në kujtesë të telefonit. Përditësimi me anë të një kompjuteri do t'i mbishkruajë të gjitha të dhënat dhe cilësimet e përdoruesit. Të dhënat e ruajtura në një kartë kujtese nuk do të preken.

## Për të përdorur Shërbimin përditësues nëpërmjet një kompjuteri

- Shkoni te [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support).

## Shërbimet e vendndodhjes

Mund të përdorni ndihmë për të gjetur rrugën dhe të ruani vendndodhjet e preferuara. Duke marrë të dhëna nga antenat celulare afër jush, mund të shihni vendndodhjen tuaj të përafërt në një hartë.

- 💡 Po të përdorni një pajisje shtesë GPS të përbalueshme nga telefoni, mund të merrni të dhëna më të sakta për vendndodhjen tuaj të tanishme.

- ! Disa funksione të Shërbimeve të vendndodhjes përdorin Internetin.


## Përdorimi i hartave Google Maps™ për celular

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Dëfrim** > **Shërbimet orientuese** > **Google Maps**.

## Për të mësuar më shumë për Google Maps


- Kur përdorni hartat Google Maps, përzgjidhni **Shtesat** > **Ndihmë**.

## Për të parë vendndodhjen tuaj të përafërt

- Kur përdorni hartat Google Maps, shtypni .

## Për të parë një vendndodhje të ruajtur

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Dëfrim** > **Shërbimet orientuese** > **Vendet e preferuara**.
- Shkoni te një vendndodhje dhe përzgjidhni **Shko te**.

- 💡 Kur përdorni hartat Google Maps, mund të shtypni  për të hyrë tek të preferuarat.

## Alarmet

Si sinjal alarmi mund të cilësoni një skedë zanore ose radion. Sinjali i alarmit do të dëgjohet edhe sikur telefoni të jetë i fikur. Kur të bjerë alarmi, mund ta heshtoni ose ta fikni krejt.


### *Për të cilësuar alarmin*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Alarmet**.
- 2 Shkoni te një alarm dhe përzgjidhni **Ndrysh**.
- 3 Shkoni te **Ora**: dhe përzgjidhni **Ndrysh**.
- 4 Futni orën dhe përzgjidhni **OK** > **Ruaje**.

### *Për të cilësuar alarmin periodik*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Alarmet**.
- 2 Shkoni te një alarm dhe përzgjidhni **Ndrysh**.
- 3 Shkoni te **Periodik**: dhe përzgjidhni **Ndrysh**.
- 4 Shkoni te një ditë dhe përzgjidhni **Shenjo**.
- 5 Për të përzgjedhur një ditë tjetër, shkoni te ajo ditë dhe përzgjidhni **Shenjo**.
- 6 Përzgjidhni **Mbarova** > **Ruaje**.

### *Për të cilësuar sinjalin e alarmit*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Alarmet**.
- 2 Shkoni te një alarm dhe përzgjidhni **Ndrysh**.
- 3 Shkoni te kartela .
- 4 Shkoni te **Sinjali i alarmit**: dhe përzgjidhni **Ndrysh**.
- 5 Gjeni dhe përzgjidhni një sinjal alarmi. Përzgjidhni **Ruaje**.

### *Për ta heshtuar alarmin*

- Kur të bjerë alarmi, shtypni një tast çfarëdo.
- Për ta përsëritur alarmin, përzgjidhni **Pauzë**.

### *Për ta fikur alarmin*

- Kur të bjerë alarmi, shtypni një tast çfarëdo dhe përzgjidhni **Fike**.


### *Për ta anuluar alarmin*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Alarmet**.
- 2 Shkoni te një alarm dhe përzgjidhni **Fike**.

### *Alarmi me telefon të heshtuar*

Alarmin mund ta cilësoni që të mos bjerë, në qoftë se telefoni është i heshtuar.

### *Për të cilësuar nëse alarmi do të dëgjohet apo jo me telefon të heshtuar.*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Alarmet**.
- 2 Shkoni te një alarm dhe përzgjidhni **Ndrysh**.
- 3 Shkoni te kartela .
- 4 Shkoni te **Në heshtim**: dhe përzgjidhni **Ndrysh**.
- 5 Përzgjidhni një mundësi shtesë.

### ***Për të cilësuar kohëzgjatjen e përgjumjes***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Alarmet**.
- 2 Shkoni te një alarm dhe përzgjidhni **Ndrysh**.
- 3 Shkoni te **Intervali i përsëritjes**: dhe përzgjidhni **Ndrysh**.
- 4 Përzgjidhni një mundësi shtesë.

### **Kalendari**

Kalendarin mund ta sinkronizoni me një kalendar në kompjuter, një kalendar në Internet ose një server Microsoft® Exchange Server (Microsoft® Outlook®).

Për të dhëna të mëtejshme, shihni *Sinkronizimi* në f. 56.

### **Pamja default**

Mund të vendosni se çfarë do të afishohet në krye, kur e hapni kalendarin: muaji, java apo dita.

### ***Për të cilësuar pamjen default***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Organizuesi** > **Kalendari**.
- 2 Përzgjidhni **Shtesat** > **Të avancuara** > **Pamje default**.
- 3 Përzgjidhni një mundësi shtesë.

### **Takimet**

Mund të shtoni takime të reja ose të ripërdorni takimet ekzistuese.

### ***Për të shtuar një takim***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Organizuesi** > **Kalendari**.
- 2 Përzgjidhni një datë.
- 3 Shkoni te **Takim i ri** dhe përzgjidhni **Shto**.
- 4 Futni të dhënat dhe konfirmojeni çdo futje.
- 5 Përzgjidhni **Ruaje**.

### ***Për ta parë takimin***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Organizuesi** > **Kalendari**.
- 2 Përzgjidhni një datë.
- 3 Shkoni te një takim dhe përzgjidhni **Shih**.

### ***Për ta ndryshuar takimin***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Organizuesi** > **Kalendari**.
- 2 Përzgjidhni një datë.
- 3 Shkoni te një takim dhe përzgjidhni **Shih**.
- 4 Përzgjidhni **Shtesat** > **Bëj ndryshime**.
- 5 Ndryshojeni takimin dhe konfirmojeni çdo futje.
- 6 Përzgjidhni **Ruaje**.

### ***Për të parë një javë kalendari***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Organizuesi** > **Kalendari**.
- 2 Përzgjidhni **Shtesat** > **Ndërro pamje** në > **Javë**.



### *Për të cilësuar si duhet të dëgjohen përkujtesat*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Organizuesi** > **Kalendari**.
- 2 Përzgjidhni një datë.
- 3 Përzgjidhni **Shtesat** > **Të avancuara** > **Përkujtesat**.
- 4 Përzgjidhni një mundësi shtesë.

! *Një shtesë përkujtese e cilësuar në kalendar do të prekë një shtesë përkujtese cilësuar në detyrat.*

### **Shënime**

Mund të mbani shënime dhe t'i ruani. Mund edhe ta afishoni një shënim në gatishmëri.

#### *Për të shtuar një shënim*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Organizuesi** > **Shënime**.
- 2 Shkoni te **Shënim i ri** dhe përzgjidhni **Shto**.
- 3 Shkruajeni shënimin dhe përzgjidhni **Ruaje**.

#### *Për ta afishuar një shënim në gatishmëri*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Organizuesi** > **Shënime**.
- 2 Shkoni te një shënim dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Afisho në gatish**.

### *Për ta hequr një shënim nga gatishmëria*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Organizuesi** > **Shënime**.
- 2 Shkoni te shënimi i afishuar në gatishmëri. Ky do të jetë i shenjuar me një ikonë. Përzgjidhni **Shtesat** > **Fshihe në gatish**.

### **Detyrat**

Mund të shtoni detyra të reja ose të ripërdorni detyrat ekzistuese.

#### *Për të shtuar një detyrë*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Organizuesi** > **Detyrat**.
- 2 Përzgjidhni **Detyrë e re** dhe përzgjidhni **Shto**.
- 3 Përzgjidhni një mundësi shtesë.
- 4 Futni hollësitë dhe konfirmoni çdo futje.

#### *Për të parë një detyrë*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Organizuesi** > **Detyrat**.
- 2 Shkoni te një detyrë dhe përzgjidhni **Shih**.

#### *Për të cilësuar si duhet të dëgjohen përkujtesat*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Organizuesi** > **Detyrat**.
- 2 Shkoni te një detyrë dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Përkujtesat**.
- 3 Përzgjidhni një mundësi shtesë.

- ! Një shtesë përkujtese e cilësuar në detyrat do të prekë një shtesë përkujtese cilësuar në kalendar.

## Profilët

Mund të ndryshoni cilësime të tilla si volumi i ziles ose sinjalizimi me dridhje, për t'ua përshtatur mjediseve të ndryshme. Mund t'i ricilësoni të gjitha profilet, për t'i kthyer ashtu siç ishin kur e bletë telefonin.

### *Për të përzgjedhur një profil*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Të përgjithshme** > **Profilët**.
- 2 Përzgjidhni një profil.

### *Për të parë dhe ndryshuar një profil*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Të përgjithshme** > **Profilët**.
- 2 Shkoni te një profil dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Shih dhe ndrysho**.

- ! *Profilët **Normal** nuk mund t'ia ndërroni emrin.*

## Ora dhe data

### *Për të cilësuar orën*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Të përgjithshme** > **Ora dhe data** > **Ora**.
- 2 Futeni orën dhe përzgjidhni **Ruaje**.

### *Për të cilësuar datën*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Të përgjithshme** > **Ora dhe data** > **Data**.
- 2 Futeni datën dhe përzgjidhni **Ruaje**.

### *Për të cilësuar zonën orare*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Të përgjithshme** > **Ora dhe data** > **Zona ime orare**.
- 2 Përzgjidhni zonën tuaj orare.

- ! *Po të përzgjidhni një qytet, funksioni **Zona ime orare** do ta përditësojë orën edhe kur të hyjë në fuqi ora verore.*

## Tema

Duke përdorur ngjyra dhe sfonde të ndryshme, mund t'ia ndryshoni pamjen ekranit. Mund edhe të krijoni tema të reja dhe t'i shkarkoni. Për të dhëna të mëtejshme, shkoni te [www.sonyericsson.com/fun](http://www.sonyericsson.com/fun).

### *Për të cilësuar një temë*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Ekran** > **Tema**.
- 2 Shkoni te një temë dhe përzgjidhni **Cilësoje**.

### **Pamja e menusë kryesore**

Mund t'ua ndryshoni pamjen ikonave në menunë kryesore.

### *Për t'ia ndryshuar pamjen menusë kryesore.*



- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Shtesat** > **Pamja menu kryes.**
- 2 Përzgjidhni një mundësi shtesë.

### **Tonet e ziles**

#### *Për të cilësuar një ton zileje*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Tinguj & sinjalizime** > **Toni i ziles**.
- 2 Gjieni dhe përzgjidhni një ton zileje.

#### *Për të cilësuar volumin e ziles*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Tinguj & sinjalizime** > **Volumi i ziles**.
- 2 Shtypni  ose  për të rregulluar volumin.
- 3 Përzgjidhni **Ruaje**.

#### *Për ta çaktivizuar tonin e ziles*

- Nga gatishmëria, mbani të shtypur .

- ! Të gjitha sinjalet, me përjashtim të sinjalit të alarmit, do të modifikohen.

### *Për të cilësuar sinjalizimin me dridhje*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Tinguj & sinjalizime** > **Me dridhje**.
- 2 Përzgjidhni një mundësi shtesë.

### **Orientimi i ekranit**

Mund të këmbeheni midis orientimeve portret dhe peizazh.

### *Për t'ia ndërruar orientimin ekranit në Media*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Media** > **Cilësimet** > **Orientimi**.
- 2 Përzgjidhni një mundësi shtesë.

### **Lojërat**

Telefoni ju vjen me një numër lojërash të parangarkuara. Lojërat edhe mund t'i shkarkoni. Shumë lojëra përmbajnë tekste ndihmëse.

### *Për të nisur lojën*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Media** > **Lojëra**.
- 2 Përzgjidhni një lojë.

### *Për të përfunduar lojën*

- Shtypni .

## Aplikacionet

Mund të shkarkoni dhe të përdorni aplikacione Java. Mund edhe të shihni të dhëna ose të cilësoni leje të tjera.

### Profilat e Internetit për aplikacione Java

Disa aplikacione Java duhet të lidhen në Internet për të marrë të dhëna. Shumica e aplikacioneve Java përdorin të njëjtat cilësime Interneti si edhe shfletuesi në telefon. Nëse nuk i përdorni dot aplikacionet Java, shihni *Mënjanimi i problemeve* në f. 69.

### *Për të përzgjedhur një aplikacion Java*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Organizuesi** > **Aplikacione**.
- 2 Përzgjidhni një aplikacion.

### *Për të parë të dhëna për një aplikacion Java*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Organizuesi** > **Aplikacione**.
- 2 Shkoni te një aplikacion dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Informacion**.

### *Për të cilësuar lejet për një aplikacion Java*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Organizuesi** > **Aplikacione**.
- 2 Shkoni te një aplikacion dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Leje**.
- 3 Cilësoni lejet.

### **Madhësia e ekranit për aplikacionet Java**

Disa aplikacione Java kërkojnë një madhësi të caktuar ekрани. Lidhuni me tregtuesin e aplikacionit për të dhëna të mëtejshme.

### *Për të cilësuar madhësinë e ekranit për një aplikacion Java*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Organizuesi** > **Aplikacione**.
- 2 Shkoni te një aplikacion dhe përzgjidhni **Shtesat** > **Prmasat ekranit**.
- 3 Përzgjidhni një mundësi shtesë.

## Kyçet

### **Kyçi i kartës SIM**

Kyçi i kartës SIM ju mbron vetëm pajtimtarinë. Telefoni do të punojë me një kartë të re. Në rast se kyçi është aktiv, do t'ju duhet të futni një PIN.

Në qoftë se e futni gabim kodin PIN tri herë radhazi, karta SIM do të bllokohet dhe do t'ju duhet të futni kodin PUK. Kodet PIN dhe PUK do t'ju jepen nga operatori i rrjetit.

### **Për ta zhblokuar kartën SIM**

- 1 Kur të afishohet kumti **PIN është i bllokuar** futni kodin PUK dhe përzgjidhni **OK**.
- 2 Futni një PIN të ri katër- deri tetëshifror dhe përzgjidhni **OK**.
- 3 Rifutni PIN-in e ri dhe përzgjidhni **OK**.

### **Për ta ndërruar kodin PIN**

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja > Cilësimet > kartela Të përgjithshme > Sigurshmëria > Kyçet > Mbrojtja e SIM > Ndërro PIN**.
- 2 Futni kodin PIN dhe përzgjidhni **OK**.
- 3 Futni një PIN të ri katër- deri tetëshifror dhe përzgjidhni **OK**.
- 4 Rifutni PIN-in e ri dhe përzgjidhni **OK**.

- ! *Po të afishohet kumti **Kodet nuk përputhen**, do ta keni futur PIN-in e ri pasaktësisht. Po të afishohet kumti **PIN i gabuar**, i pasuar nga **PIN i vjetër**, e keni futur PIN-in e vjetër pasaktësisht.*

### **Për të përdorur kyçin e kartës SIM**

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja > Cilësimet > kartela Të përgjithshme > Sigurshmëria > Kyçet > Mbrojtja e SIM > Mbrojtja**.
- 2 Përzgjidhni një mundësi shtesë.
- 3 Futni kodin PIN dhe përzgjidhni **OK**.

### **Kyçi i telefonit**

Mund ta bllokoni përdorimin e paautorizuar të telefonit tuaj. Kodin e kyçit të telefonit (0000 si default) mund ta ndërroni me një kod katër deri-tetëshifror çfarëdo.

- ! *Ka rëndësi që ta mbani mend kodin e ri. Po ta harroni kodin e ri, duhet ta çoni telefonin te një tregtore Sony Ericsson për ta zhblokuar.*

### **Për të përdorur kyçin e telefonit**

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja > Cilësimet > kartela Të përgjithshme > Sigurshmëria > Kyçet > Mbrojtja e telefonit > Mbrojtja**.
- 2 Përzgjidhni një mundësi shtesë.
- 3 Futni kodin kyçës të telefonit dhe përzgjidhni **OK**.

### **Për ta shkyçur telefonin**

- Futni kodin dhe përzgjidhni **OK**.

### ***Për ta ndërruar kodin e kyçit të telefonit***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Të përgjithshme** > **Sigurshmëria** > **Kyçet** > **Mbrojtja e telefonit** > **Ndërro kodin**.
- 2 Futni kodin e vjetër dhe përzgjidhni **OK**.
- 3 Futni kodin e ri dhe përzgjidhni **OK**.
- 4 Përsëriteni kodin dhe përzgjidhni **OK**.

### **Kyçi i tastierës**


Këtë kod mund ta aktivizoni për të mos lejuar telefonimin aksidentalisht. Telefonatave në hyrje mund t'u përgjigjeni pa e zhblokuar tastierën.

- ! Gjithnjë mund t'i telefononi numrit ndërkombëtar të urgjencës 112.

### ***Për të përdorur tastkyçjen automatike***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** > **Cilësimet** > kartela **Të përgjithshme** > **Sigurshmëria** > **Tastkyçe automat**.
- 2 Përzgjidhni një mundësi shtesë.

### ***Për të kyçur tastierën manualisht***

- Nga gatishmëria, shtypni  dhe përzgjidhni **Kyçe**.






### ***Për ta shkyçur tastierën manualisht***

- Nga gatishmëria, shtypni  dhe përzgjidhni **Shkyçe**.

### **Numri IMEI**

Ruani një kopje të numrit IMEI (Identiteti Ndërkombëtar i Pajisjeve Celulare, ose International Mobile Equipment Identity në anglishte), i cili do t'ju duhet në rast se telefonin jua vjedhin.

### ***Për ta parë numrin IMEI***

- Nga gatishmëria, shtypni , , , , .

# Mënjanimi i problemeve

Për disa probleme i duhet telefonuar operatorit të rrjetit.

Për ndihmë të mëtejshme, vizitoni [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support).

## Pyetje që bëhen shpesh


*Nuk mund të sinkronizoj me një shërbim Interneti, të përdor Internetin, PlayNow™, TrackID™, Shokët e mi, aplikacionet Java, mesazhimin-figurë, postën elektronike ose blogimin*

Pajtimtaria juaj nuk e parashikon transmetimin e të dhënave. Cilësimet mungojnë ose nuk janë të sakta.

Cilësimet mund t'i shkarkoni duke përdorur udhëzoriin e konfigurimit ose duke shkuar të [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support).

*Për t'i shkarkuar cilësimet me anë të udhëzorit të konfigurimit*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja > Cilësimet > kartela Të përgjithshme > Udhëzori i konfigur.** > Shkarko cilësimet.
- 2 Ndiqni udhëzimet që afishohen.

 Lidhuni me operatorin e rrjetit ose ofruesin e shërbimit për të dhëna të mëtejshme.

*Kam probleme me kapacitetin e kujtesës ose telefoni po punon ngadalë*  
Riniseni telefonin çdo ditë, për të hapur vend në kujtesë, ose kryeni një **Ricilëso të gjitha**.

## Ricilësimi bazë

Po të përzgjidhni **Ricilëso cilësimet**, edhe ndryshimet që u keni bërë cilësimeve do të fshihen.

Po të përzgjidhni **Ricilësoji të gjitha**, do të fshihen jo vetëm cilësimet tuaja, por edhe materiale të tilla si kontaktet, mesazhet, fotot, tingujt dhe lojërat që keni shkarkuar. Mund edhe të humbni materiale që ishin në telefon në kohën kur e bletë.

## Për ta ricilësuar telefonin

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja > Cilësimet > kartela Të përgjithshme > Ricilëso të gjitha**.
- 2 Përzgjidhni një mundësi shtesë.
- 3 Ndiqni udhëzimet që afishohen.

*Nuk po e ngarkoj dot telefonin, ose bateria ka kapacitet të ulët*  
Nuk e keni lidhur mirë ngarkuesin ose ka problem me kontaktet e baterisë. Hiqeni baterinë dhe pastrojani kontaktet.

Bateria është vjetëruar dhe duhet zëvendësuar. Shihni **Për të ngarkuar baterinë** në f. 9.

### ***Kur nis të ngarkoj telefonin nuk shoh të afishohet në ekran ikona e baterisë***

Mund të duhet të kalojnë disa minuta para se ikona e baterisë të afishohet në ekran.

### ***Disa mundësi shtesë në menu më dalin në ngjyrë hiri***

Shërbimi nuk është aktivizuar. Lidhuni me operatorin e rrjetit.

### ***Nuk i përdor dot mesazhet SMS/shkrimore në telefon***

Duhet të keni numrin e qendrës së shërbimit. Numrin jua jep ofruesi i shërbimit dhe zakonisht e keni të regjistruar në kartën SIM. Në rast se numri i qendrës së shërbimit nuk gjendet në kartën SIM, duhet ta futni ju vetë.

### ***Për të futur një numër të qendrës së shërbimit***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja > Mesazhimi > Cilësimet > Mesazh shkrimor** dhe shkoni te **Qendra e shërbimit**. Numri do të afishohet, po të jetë ruajtur në kartën SIM.
- 2 Po të mos afishohet ndonjë numër, përzgjidhni **Ndrysh**.
- 3 Shkoni te **Qendër e re shërbimi** dhe përzgjidhni **Shto**.

4 Futni numrin, së bashku me shenjë ndërkombëtare «+» dhe prefiks të shtetit.

5 Përzgjidhni **Ruaje**.

### ***Nuk po i përdor dot mesazhet-figurë në telefon***

Duhet të cilësoni një profil MMS dhe adresën e serverit të mesazheve. Në qoftë se nuk ka ndonjë profil MMS ose server mesazhesh, mund t'i kërkonti operatorit të rrjetit që t'ju dërgojë cilësimet automatikisht ose në [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support).

### ***Për të përzgjedhur një profil MMS***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja > Mesazhimi > Cilësimet > Mesazh-figurë > Profili MMS**.
- 2 Përzgjidhni një profil.

### ***Për të cilësuar adresën e serverit të mesazheve***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja > Mesazhimi > Cilësimet > Mesazh-figurë**.
- 2 Shkoni te **Profili MMS** dhe përzgjidhni **Ndrysh**.
- 3 Përzgjidhni **Shtesat > Ndrysh**.
- 4 Shkoni te **Serveri i mszheve** dhe përzgjidhni **Ndrysh**.
- 5 Futni adresën dhe përzgjidhni **OK > Ruaje**.



## ***Telefonit nuk i dëgjohet zilha, ose zilha është shumë e dobët***

Sigurohuni që **Heshtim** nuk është cilësuar si **Aktiv**. Shihni *Për ta çaktivizuar tonin e ziles në f. 65.*

Kontrolloni volumin e ziles. Shihni *Për të cilësuar volumin e ziles në f. 65.*

Kontrolloni profilin. Shihni *Për të përzgjedhur një profil në f. 64.*

Kontrolloni mundësitë shtesë të devijimit të telefonatës që po përdorni. Shihni *Për të devijuar telefonata në f. 37.*

## ***Telefoni nuk është i gjatshëm nga pajisje të tjera që përdorin radioteknologjinë Bluetooth***

Nuk e keni aktivizuar funksionin Bluetooth në telefon. Sigurohuni që telefonin e keni cilësuar si të gjatshëm. Shihni *Për ta aktivizuar funksionin Bluetooth në f. 26.*

## ***Nuk po sinkronizoj as po transferoj dot materiale midis telefonit dhe kompjuterit, nëpërmjet lidhjes me kablo USB.***

Kabllloja ose programet që ju kanë ardhur me telefonin nuk janë instaluar si duhet. Shkoni te [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support) për të lexuar udhëzues «Getting started»

(«Për të filluar»), të cilët përmbajnë udhëzime instalimi të hollësishme dhe udhëzues për mënjanim problemesh.


## ***E kam harruar kodkalimin për kujtesën e kodeve***

Po ta harroni kodkalimin, duhet ta ricilësoni kujtesën e kodeve. Të gjitha të dhënat që keni atje do të fshihen. Kur të hyni në kujtesën e kodeve herën tjetër, duhet të veproni sikur po e hapni për herë të parë.

## ***Për ta ricilësuar kujtesën e kodeve***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja > Organizuesi > Kujtesa e kodeve**.
- 2 Futni një fjalëkalim jokorrekt 3 herë.
- 3 **Ta ricilësoj kujtesën e kodeve?** afishohet.
- 4 Përzgjidhni **Po**.

***Ku mund të gjej të dhëna identifikuese, të tilla si numrin tim IMEI, në rast se nuk e ndez dot telefonin?***



## Mesazhet e gabimit

### Fut një kartë SIM

Nuk ka kartë SIM në telefon, ose mund ta keni instaluar gabim.

Shihni *Për të futur kartën SIM* në f. 9.

Kontaktet e kartës SIM kanë nevojë të pastrohen. Lidhuni me operatorin e rrjetit, në qoftë se karta është e dëmtuar.

### Fut një kartë SIM korrekte

Telefoni është programuar të punojë vetëm me disa karta SIM të caktuara. Sigurohuni që po përdorni një kartë SIM të përshtatshme për operatorin tuaj.

### PIN i gabuar ose PIN2 i gabuar

E keni futur gabim numrin PIN ose PIN2.

Futni PIN ose PIN2 korrekt dhe përzgjidhni **Po**. Shihni *PIN* në f. 6.

### PIN është i bllokuar ose PIN2 i bllokuar

E keni futur numrin PIN ose PIN2 gabim tri herë radhazi.

Për ta zhbllokuar, shihni *Kyçi i kartës SIM* në f. 66.

### Kodet nuk përputhen

Kodet që keni futur nuk përkojnë. Kur jeni duke ndërruar një kod të sigurshmërisë, për shembull kodin PIN, duhet ta konfirmoni kodin e ri. Shihni *Kyçi i kartës SIM* në f. 66.

### Nuk ka sinjal rrjeti

Telefoni juaj është profiluar për avion. Shihni *Profili avion* në f. 59.

Telefonit nuk po i mbërrin sinjal rrjeti, ose sinjali është tepër i dobët. Lidhuni me operatorin e rrjetit për t'u siguruar nëse ka sinjal të rrjetit atje ku ndodhni.

Karta SIM nuk po punon mirë. Futeni kartën SIM në një telefon tjetër. Nëse ashtu punon, ka të ngjarë që problemin ta shkaktojë telefoni. Lidhuni me qendrën më të afërt të shërbimit Sony Ericsson.

### Vetëm tlf. urgjence

Jeni brenda rrezes së një rrjeti, por nuk ju lejohet ta përdorni. Megjithatë, në rast të një urgjence, disa operatorë rrjeti ju lejojnë t'i telefononi, për shembull, numrin ndërkombëtar të urgjencës 112. Shihni *Telefonata të urgjencës* në f. 30.

### PUK i bllokuar. Lidhu me operatorin.

E keni shkruar kodin PUK gabim 10 herë radhazi.

# Të dhëna të rëndësishme

## Selia në Internet e Sony Ericsson për Konsumatorin

Në [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support) do të gjeni një seksion ku ju ofrohet ndihmë dhe këshilla praktike. Këtu gjeni edhe përditësimet më të fundit të programeve dhe këshilla si ta përdorni produktin tuaj në mënyrë sa më të frytshme.

## Shërbim dhe ndihmë teknike

Ju mund të përdorni një paketë shërbimesh të posaçme, të tilla si:

- Seli Interneti globale dhe lokale, që ju ofrojnë asistencë
- Një rrjet global Qendrash Telefonimi Call Centers

## Ndihmë

Argentina	800-333-7427
Australia	1-300650-600
Belgique/België	02-7451611
Brasil	4001-04444
Canada	1-866-766-9374
Central Africa	+27 112589023
Chile	123-0020-0656
Colombia	18009122135
Česká republika	844550 055
Danmark	33 31 28 28
Deutschland	0180 534 2020
Ελλάδα	801-11-810-810 210-89 91 919
España	902 180 576
France	0 825 383 383
Hong Kong/香港	8203 8863
Hrvatska	062 000 000
India/भारत	39011111
Indonesia	021-2701388

- Një rrjet të gjerë partnerësh shërbimi Sony Ericsson
- Një periudhë garancie. Njihuni më mirë me kushtet e garancisë, duke lexuar *Të dhënat e rëndësishme*.

Në selinë [www.sonyericsson.com](http://www.sonyericsson.com), do të gjeni të dhëna dhe mjete ndihmëse nga më të fundit. Për shërbime dhe funksione që varen nga operatori, lidhuni me operatorin e rrjetit tuaj.

Mund edhe të lidheni me Qendrat tona të Telefonimit Call Centers. Në rast se vendi ose zona juaj gjeografike nuk figurojnë në listën e mëposhtme, lidhuni me koncesionarin tuaj lokal. (Telefonata do t'ju faturohet sipas tarifave ndërryqetëse, duke përfshirë edhe taksat vendore, me përjashtim të atyre rasteve kur numri i telefonit është numër falas.)

Nëse produkti juaj ka nevojë të riparohet, lidhuni me tregtarin që jua ka shitur ose me një nga partnerët tanë të shërbimit. Për reklamime të garancisë, ruani dëftesën e blerjes.

questions.AR@support.sonyericsson.com  
questions.AU@support.sonyericsson.com  
questions.BE@support.sonyericsson.com  
questions.BR@support.sonyericsson.com  
questions.CA@support.sonyericsson.com  
questions.CF@support.sonyericsson.com  
questions.CL@support.sonyericsson.com  
questions.CO@support.sonyericsson.com  
questions.CZ@support.sonyericsson.com  
questions.DK@support.sonyericsson.com  
questions.DE@support.sonyericsson.com  
questions.GR@support.sonyericsson.com

questions.ES@support.sonyericsson.com  
questions.FR@support.sonyericsson.com  
questions.HK@support.sonyericsson.com  
questions.HR@support.sonyericsson.com  
questions.IN@support.sonyericsson.com  
questions.ID@support.sonyericsson.com

Ireland	1850 545 888
Italia	06 48895206
Lietuva	8 70055030
Magyarország	+36 1 880 4747
Malaysia	1-800-889900
México	01 800 000 4722
Nederland	0900 899 8318
New Zealand	0800-100150
Norge	815 00 840
Österreich	0810 200245
Pakistan	111 22 55 73 (92-21) 111 22 55 73
Philippines/Pilipinas	02-6351860
Polska	0 (prefiks) 22 6916200
Portugal	808 204 466
România	(+4021) 401 0401
Россия	8 (495) 787 0986
Schweiz/Suisse/Svizzera	0848 824 040
Singapore	67440733
Slovensko	02-5443 6443
South Africa	0861 6322222
Suomi	09-299 2000
Sverige	013-24 45 00
Türkiye	0212 473 77 71
Україна	(+0380) 44 590 1515
United Kingdom	08705 23 7237
United States	1-866-7669347
Venezuela	0-800-100-2250
الإمارات العربية المتحدة	43 919880
中国	4008100000
台灣	02-25625511
ᐅᐅᐅ	02-2483030

questions.IE@support.sonyericsson.com  
 questions.IT@support.sonyericsson.com  
 questions.LT@support.sonyericsson.com  
 questions.HU@support.sonyericsson.com  
 questions.MY@support.sonyericsson.com  
 questions.MX@support.sonyericsson.com  
 questions.NL@support.sonyericsson.com  
 questions.NZ@support.sonyericsson.com  
 questions.NO@support.sonyericsson.com  
 questions.AT@support.sonyericsson.com  
 questions.PK@support.sonyericsson.com

questions.PH@support.sonyericsson.com  
 questions.PL@support.sonyericsson.com  
 questions.PT@support.sonyericsson.com  
 questions.RO@support.sonyericsson.com  
 questions.RU@support.sonyericsson.com  
 questions.CH@support.sonyericsson.com  
 questions.SG@support.sonyericsson.com  
 questions.SK@support.sonyericsson.com  
 questions.ZA@support.sonyericsson.com  
 questions.FI@support.sonyericsson.com  
 questions.SE@support.sonyericsson.com  
 questions.TR@support.sonyericsson.com  
 questions.UA@support.sonyericsson.com  
 questions.GB@support.sonyericsson.com  
 questions.US@support.sonyericsson.com  
 questions.VE@support.sonyericsson.com  
 questions.AE@support.sonyericsson.com  
 questions.CN@support.sonyericsson.com  
 questions.TW@support.sonyericsson.com  
 questions.TH@support.sonyericsson.com

## Udhëzime për përdorim të sigurt dhe të frytshëm

Lutemi ndiqini me kujdes. Po të mos veproni kështu, produkti rrezikon të mos funksionojë mirë. Po të keni ndonjë dyshim në lidhje me funksionimin, kërkoni ndonjë partneri shërbimi të certifikuar që t'ju kontrollojë produktin para se ta ngarkoni ose ta përdorni.



### Rekomandime për kujdesin dhe përdorimin e sigurt të produkteve tona

- Trajtojeni produktin me kujdes dhe mbajeni në një vend të pastër e pa pluhur.
- Vini Re! Mund të shpërthyejë po të hidhet në zjarr.
- Mos lejoni që produkti të bjerë në kontakt me lëngje, lagështi të tepërt ose objekte të lagura.
- Për të siguruar rendiment optimal, telefoni juaj Sony Ericsson nuk duhet përdorur në temperatura më të ulëta se  $-10^{\circ}\text{C}$  ( $+14^{\circ}\text{F}$ ) ose më të larta se  $+45^{\circ}\text{C}$  ( $+113^{\circ}\text{F}$ ). Mos e lini baterinë në temperatura më të larta se  $+60^{\circ}\text{C}$  ( $+140^{\circ}\text{F}$ ).
- Mos lejoni që t'u ekspozohet flakëve ose duhanit të ndezur.
- Mos e lini produktin të bjerë në tokë, mos e hidhni në ajër e mos u përpiqni ta përkulni.
- Mos e lyeni me bojë, as mos u përpiqni ta zbrërtheni ose ta modifikoni produktin. Vetëm personeli i autorizuar nga Sony Ericsson duhet ta riparojë produktin.
- Para se ta përdorni produktin në afërsi të stimuluesve kardiakë ose pajisjeve të tjera, këshillohuni me personelin mjekësor të autorizuar dhe lexoni udhëzimet e fabrikantit të pajisjes mjekësore.



- Atje ku është e nevojshme ose ju kërkohet, ndërpriteni përdorimin e pajisjeve elektronike ose çaktivizojeni funksionin radiotransmetues të pajisjes.
- Mos e përdorni produktin atje ku atmosfera është potencialisht shpërthyes.
- Mos e vendosni produktin në zonë mbi air bag-un e veturës suaj, as mos instaloni atje pajisje radiodhënëse e marrëse.
- Kujdes: Po të kriset ose të thyhet ekrani, do të përftonë cifra ose cepa të mpërthetë që mund t'ju lëndojnë në rast se i prekni.
- Mos e përdorni kufjen Bluetooth në pozicione të parehatshme, ose atje ku mund të shtypet.



### Fëmijët

Vini Re! Mbajeni larg fëmijëve. Mos i lejoni fëmijët të luajnë me telefona celularë ose pajisje shtesë. Mund të lëndojnë veten ose të tjerët. Produktet përmbajnë pjesë të vogla që mund të shkapëten dhe të krijojnë rrezik mbytjeje.



### Ushqyesi (Ngarkuesi)

Lidhni ngarkuesin vetëm me burime rryme që u përgjigjen simboleve të shenjara në produkt. Mos e përdorni në natyrë, ose në vende me lagështi. Mos e modifikoni kordonin, mos e tërhiqni fort e mos lejoni të dëmtohet. Shkëputeni njësinë nga priza para se ta pastroni. Kurrë mos i bëni modifikime spinës. Në qoftë se nuk arrini ta futni në prizë, kërkoni një elektricisti që t'ju instalojë një prizë të përshtatshme. Kur ushqyesi është i lidhur me rrjetin elektrik, gjithnjë konsumon pak energji. Për të shmangur këtë shpërdorim të vogël energjie, shkëputeni ushqyesin nga priza kur produkti të jetë ngarkuar plotësisht. Përdorimi i pajisjeve ngarkuese që nuk e afishojnë markën Sony Ericsson, mund të shoqërohet me rreziqe të shtuara për sigurinë.

## Bateria

Bateritë e reja ose që nuk janë përdorur për një kohë të gjatë mund të funksionojnë, përkohësisht, me kapacitet të ulur. Ngarkojeni plotësisht baterinë para se ta përdorni për herë të parë. Përdoreni vetëm për telefonin celular. Ngarkojeni baterinë në temperatura midis +5°C (+41°F) dhe +45°C (+113°F). Mos e futni baterinë në gojë. Mos lejoni që kontaktet e baterisë të prekin një tjetër objekt metalik. Fikeni produktin para se të hiqni baterinë. Rendimenti i baterisë varet nga temperatura, forca e sinjalit, zakonet e përdorimit, funksionet e përzgjedhura dhe transmetimet zanore ose dhanore. Bateritë e trupëzuara në pajisjet duhet të çmontohen ose ndërrohen vetëm nga partnerë shërbimi Sony Ericsson. Përdorimi i baterive që nuk e afishojnë markën Sony Ericsson, mund krijojë probleme sigurie. Zëvendësojeni baterinë vetëm me një bateri tjetër Sony Ericsson që është miratuar për produktin tuaj, sipas standardit IEEE-1725. Po të përdorni një bateri të pamiraturar, mund t'i ekspozoheni rrezikut të zjarrit, shpërthimit, rrjedhjes ose ndonjë aksidenti tjetër.

## Pajisjet mjekësore personale

Telefonat celularë mund të ndikojnë në funksionimin e disa pajisjeve mjekësore të implantuara. Po të ruani një distancë prej të paktën 15 cm (6 inç) midis telefonit dhe pajisjes, do ta kufizoni rrezikun e interferencës. Përdoreni telefonin në veshin e djathtë. Mos e mbani telefonin në xhepin e majtë të këmbës ose të xhakëtës. Po të dyshoni se po ndodh interferencë, fikeni telefonin. Për të gjitha pajisjet mjekësore, këshillohuni me mjekun dhe fabrikantin e pajisjes.

## Kur jeni në timon

Disa fabrikantë automjetesh e ndalojnë përdorimin e telefonave celularë në automjetet, në rast se nuk është instaluar një sistem telefonimi pa duar me antenë të jashtme. Këshillohuni me përfaqësuesin

e fabrikantit të automjetit, për t'u siguruar se telefoni juaj celular ose pajisja pa duar Bluetooth nuk do të ndikojë në sistemet elektronike të automjetit. Gjithnjë kushtojini vëmendje të plotë timonit dhe zbatoni ligjet dhe rregulloret lokale për përdorimin e pajisjeve pa tel në automjet.

## Funksione të vendndodhjes/GPS

Disa produkte ofrojnë funksione të vendndodhjes/GPS. Këto funksione ofrohen «Siç janë» dhe «Me gjithë mangësitë». Sony Ericsson nuk merr përsipër ndonjë përgjegjësi, as garanci, për saktësinë e të dhënave të vendndodhjes. Përdorimi i të dhënave të vendndodhjes nga telefoni mund të mos ndodhë pa ndërprerje as pa gabime dhe mund të varet edhe nga përdorshmëria e shërbimit të rrjetit. Kini parasysh se në mjediset të caktuara, të tilla si në brendësi të ndërtesave ose në zona pranë tyre funksionaliteti i këtij shërbimi mund të reduktohet.

Kujdes: Mos i përdorni funksionet GPS në mënyrë të tillë që t'ju zhvendosë vëmendjen nga timoni.

## Telefonatat e urgjencës

Telefonat nuk mund të garantohen në të gjitha rrethanat. Asnjëherë nuk duhet ta trajtoni telefonin celular si të vetmin mjet për komunikime me rëndësi të posaçme. Telefonatat mund të mos jenë të realizueshme kudo, në të gjitha rrjetet dhe/ose në rastet kur përdoren shërbime të caktuara të rrjetit dhe/ose funksione të telefonit.

## Antena

Përdorimi i pajisjeve antena që nuk janë tregtuzuar nga Sony Ericsson mund t'ju dëmtojë telefonin celular, t'ia ulë rendimentin, dhe të prodhojë nivele të SAR mbi kufijtë e përcaktuar me ligj. Mos e mbuloni antenën me dorë, pse kjo ndikon në cilësinë e telefonatës, nivelet e konsumit të energjisë dhe mund të shkurtojë kohëzgjatjen e bisedës dhe të gatishmërisë.

## **Ekspozimi ndaj Energjisë Radiovalore (RF) dhe Shkalla Specifike e Përthithjes (SAR)**

Kur telefoni juaj ose pajisja Bluetooth pa duar janë të ndezura, lëshojnë energji radiovalore me nivel të ulët. Direktivat ndërkombëtare të sigurisë mbështeten në vlerësime të herëpashershme dhe tërësore të studimeve shkencore. Këto direktiva përcaktojnë nivelet e lejuara të ekspozimit radiovalor. Direktivat parashikojnë edhe një kufi sigurie, qëllimi i të cilit është të garantojë sigurinë e të gjithëve, si dhe të merren parasysh luhatjet në matjet.

Shkalla Specifike e Përthithjes (Specific Absorption Rate në anglishte, ose SAR) përdoret për të matur energjinë radiovalore të përthithur nga trupi gjatë përdorimit të një telefoni celular. Vlera SAR përcaktohet në nivelin më të lartë të energjisë të certifikueshëm në kushte laboratorike, por nivelet reale të SAR gjatë funksionimit të telefonit celular mund të jenë mjaft më të ulëta se kjo vlerë, sepse telefoni përdor fuqinë minimale të sinjalit që mjafton për t'u lidhur me rrjetin e përzgjedhur. Nuk ka prova që diferenat në vlerat SAR shoqërohen me diferenca të sigurisë.

Produktet radiotransmetuese që tregtohen në SHBA duhet të certifikohen nga Komisioni Federal i Komunikimeve (FCC). Atje ku kërkohet, kryhen teste me telefonin të mbajtur në vesh ose në trup. Për funksionim të telefonit në trup, telefoni është testuar i mbajtur në një distancë prej të paktën 15 mm larg trupit, pa ndonjë pjesë metalike në afërsi të telefonit, ose i mbajtur në trup, me një pajisje Sony Ericsson të përshtatshme. Për të dhëna të mëtejshme rreth SAR dhe ekspozimit ndaj energjisë radiovalore vizitoni: [www.sonyericsson.com/health](http://www.sonyericsson.com/health).

## **Profilin Avion**

Kur jeni në profilin Avion, mund ta aktivizoni funksionalitetin Bluetooth dhe WLAN, por kjo mund t'ju ndalojë kur jeni në avion ose në zona të tjera ku ndalohen transmetimet radio. Para se të përdorni funksionet Bluetooth ose WLAN në mjedise të tilla, sigurohuni që jeni të autorizuar të veproni ashtu.

## **Programet dëmtuese (Malware)**

Programet dëmtuese (malware) mund t'ju dëmtojnë telefonin celular, ose kompjuterin. Të tilla janë viruset, krimbat, programet spiunuese dhe të tjera programe të padëshiruara. Edhe pse pajisja juaj përdor masa sigurie për t'u mbrojtur ndaj këtyre programeve, Sony Ericsson nuk garanton, as merr përsipër që pajisja nuk do të preket nga ndonjë program dëmtues. Megjithatë, ju vetë mund ta ulni rrezikun e një sulmi dëmtues duke treguar kujdes kur shkarkoni materiale nga Interneti ose kur pranoni programe aplikative; ose duke mos hapur mesazhe nga burime të panjohura, ose duke mos i përgjigjur këtyre mesazheve; duke përdorur shërbime të besuara për t'u futur në Internet dhe duke shkarkuar në telefon vetëm materiale nga burime të njohura e të besueshme.

## **Pajisjet shtesë**

Përdorni vetëm pajisje Sony Ericsson origjinale, ose të partnerëve të certifikuar të shërbimit. Sony Ericsson nuk i provon paraprakisht pajisjet shtesë të palëve të treta. Pajisjet shtesë mund të ndikojnë në ekspozimin radiovalor, rendimentin e radios, volumin e zërit, sigurinë elektrike dhe fusha të tjera. Pajisjet shtesë dhe pjesët e këmbimit prodhuan nga palët të treta mund të përbëjnë rrezik për shëndetin ose sigurinë tuaj dhe t'ia ulin rendimentin telefonit.

## Zgjidhje të përdorueshmërisë/Nevoja të posaçme

Në SHBA, disa telefona Sony Ericsson kompatibël mund të përdoren me terminale TTY (së bashku me një pajisje të posaçme). Për të dhëna të mëtejshme, telefonojini qendrës Sony Ericsson Special Needs Center në numrin 877 878 1996 (TTY) ose 877 207 2056 (zanore), ose vizitoni [www.sonyericsson-snc.com](http://www.sonyericsson-snc.com).

## Eliminimi i pajisjeve të vjetra elektrike dhe elektronike

Pajisjet elektronike dhe bateritë nuk duhen eliminuar në plehrat shtëpiake, por duhen lënë në një pikë grumbullimi të posaçme për riciklim. Kjo ndihmon të mënjanohej pasoja potencialisht negative ndaj mjedisit dhe shëndetit të njeriut. Këshillohuni me rregulloret lokale, duke u lidhur me zyrën e bashkisë së qytetit tuaj, shërbimin e trajtimit të plehrave tuaja shtëpiake, tregtoren ku e keni blerë produktin, ose duke i telefonuar një qendër telefonimi Sony Ericsson Call Center.



## Eliminimi i baterisë

Zbatoni rregulloret lokale ose telefonojini një qendër telefonimi Sony Ericsson Call Center për të dhëna të mëtejshme. Kurrë mos përdorni plehrat komunale.



## Karta e kujtesës

Në qoftë se produkti ju vjen së bashku me një kartë kujtese portative, kjo do të jetë e pajtueshme me telefonin vetë, por mund të mos jetë e pajtueshme me pajisje të tjera, ose me funksionet e kartave të tyre të kujtesës. Para se t'i bleni pajisjet e tjera, sigurohuni se janë kompatibël me kartën tuaj. Nëse

produkti juaj vjen me një lexues kartash kujtese, kontrolloni kompatibilitetin para se ta bleni ose ta përdorni kartën.

Karta e kujtesës ju vjen e formatuar. Për ta riformatuar kartën e kujtesës, përdorni një pajisje kompatibël. Mos përdorni formatin e sistemit operativ standard për formatimin e kartës së kujtesës në një PC. Për hollësi të mëtejshme, lexoni udhëzimet për përdorimin e pajisjes ose lidhuni me ndihmën për klientin.

## Vini Re!

Në qoftë se pajisja juaj kërkon një përshtatës për t'u futur në telefon ose në ndonjë pajisje tjetër, mos e futni kartën drejtpërdrejt, pa përshtatësin e duhur.

## Kur e përdorni kartën e kujtesës

- Mbrojeni kartën e kujtesës nga lagështia.
- Mos i prekni kontaktet me dorë ose me ndonjë objekt metalik.
- Mos e goditni, përkulni ose hidhni në tokë kartën e kujtesës.
- Mos u përipiqi ta zbrërtheni ose ta modifikoni kartën e kujtesës.
- Mos e përdorni as mos e lini kartën e kujtesës në mjedise të lagështa ose gërryese ose tepër të nxehta, si në një veturë të mbyllur në verë, në diell ose afër ndonjë ngrohësi, etj.
- Mos e shtypni as mos e përkulni me forcë skajin e përshtatësit të kartës së kujtesës.
- Mos lejoni që në folenë e përshtatësit të kartës të grumbullohen papastërti, pluhur ose objekte të huaja.
- Sigurohuni që e keni futur kartën mirë.
- Futeni kartën e kujtesës duke e shtyrë deri në fund brenda përshtatësit. Karta e kujtesës mund të mos funksionojë mirë, po të mos futet deri në fund.
- Ju rekomandojmë të mbani kopje rezervë të të dhënave të rëndësishme. Nuk mbajmë përgjegjësi në qoftë se materialet që ruani në kartë të kujtesës humbasin ose dëmtohen.



- Të dhënat e regjistruara mund të dëmtohen ose të humbasin kur e hiqni kartën e kujtesës ose përshtatësin e kartës së kujtesës, e fikni pajisjen gjatë formatimit, leximit ose shkrimit të të dhënave; ose e përdorni kartën e kujtesës në mjedise me elektricitet statik ose fusha elektro-magnetike të fuqishme.

## Mbrojtja e informacionit vetjak

Fshijini të dhënat vetjake para se ta eliminoni produktin. Për të fshirë të dhëna, kryeni një ricilësim bazë. Fshirja e materialit nga kujtesa e telefonit nuk garanton që ky informacion nuk do të mund të recuperohet më pas. Sony Ericsson nuk garanton ndaj mundësisë për recuperim, as merr përsipër ndonjë përgjegjësi në rast bërjeje publike të atij informacioni, madje edhe sikur ju të keni kryer ricilësimin bazë.

## Paralajmërim për dëmtim të dëgjimit

Mos përdorni volum zëri aq të lartë sa t'ju dëmtohet dëgjimi.

## Marrëveshja e licensës së përdoruesit

Programet që ju janë dhënë me këtë pajisje dhe mediat e saj janë pronë e Sony Ericsson Mobile Communications AB, dhe/ose filialeve, furnitorëve dhe licensuesve të saj.

Sony Ericsson ju jep një licensë joekskluzive të kufizuar për t'i përdorur Programet vetëm në bashkëlidhje me Pajisjen ku ato janë instaluar ose me të cilën ju janë dorëzuar. Pronësi e Programeve nuk shitet, transferohet ose përcillet me ndonjë mënyrë tjetër.

Mos përdorni asnjë lloj mënyre për të zbuluar kodin burimor ose ndonjë përbërëse të Programeve, mos i riprodhoni as mos ua jepni të tjerëve Programet, mos i modifikoni. Ju jeni i autorizuar që t'ia transferoni një pale të tretë të gjitha të drejtat dhe

detyrimet në lidhje me programet, por vetëm së bashku me pajisjen me të cilën i morët këto Programe, me kusht që kjo pale e tretë të pranojë me shkrim që u nënshtrohet këtyre rregullave. Kjo licensë vlen për sa kohë do të mbetet e përdorshme Pajisja. Mund të zgjidhet duke ia transferuar një pale të tretë me shkrim të drejtat tuaja ndaj Pajisjes.

Nëse nuk i përmbaheni ndonjërit prej termave dhe kushteve të parashtruara në këtë licensë, licensa do të zgjidhet me efekt të menjëhershëm.

Sony Ericsson dhe furnizuesit dhe licensuesit e vet palë të treta i ruajnë të gjitha të drejtat, titujt dhe interesat në lidhje me këto Programe. Sony Ericsson, dhe – në atë masë që Programet përmbajnë material ose kod të një pale të tretë – kjo palë e tretë, do të konsiderohen si përfitues palë të treta të autorizuar të këtyre termave.

Kjo licensë qeveriset nga ligjet e Suedisë. Sa më sipër do të vlejë, sipas rastit, për të drejtat statutores të konsumatorit.

## Garancia e kufizuar

Sony Ericsson Mobile Communications AB, Nya Vattentornet, SE-221 88 Lund, Sweden, (Sony Ericsson) ose filiali i saj lokal, ofron këtë Garanci të Kufizuar për telefonin tuaj celular dhe pajisjet shtesë origjinale që ju janë dorëzuar së bashku me telefonin celular dhe/ose produktin tuaj kompjuterik mobil (këtej e tutje të referuara si «Produkti»).

Në rast se Produkti do të ketë nevojë për shërbime të garancisë, kthejeni në tregtoren ku e bletë ose lidhuni me qendrën vendore të telefonimit Sony Ericsson Call Center (mund t'ju duhet të paguani tarifa ndërqytetëse) ose vizitoni [www.sonyericsson.com](http://www.sonyericsson.com) për të marrë të dhëna të mëtejshme.

## Garancia që ofrojmë

Në varësi të kushteve të kësaj Garancie të kufizuar, Sony Ericsson garanton që Produkti është i lirë nga defekte projektimi, materiali dhe montimi në momentin e blerjes fillestare nga konsumatori. Kjo Garanci e kufizuar do të zgjatë për një periudhë një (1) vjeçare duke filluar nga data e blerjes fillestare të Produktit.

## Çfarë zotohemi të bëjmë

Në rast se, gjatë periudhës së garancisë, ky Produkt nuk funksionon si duhet, në kushte përdorimi dhe shërbimi normal, për shkak defektesh projektimi, materiali dhe montimi, shpërndarësit e autorizuar ose partnerët e shërbimit Sony Ericsson në vendin/rajonin\* ku e keni blerë Produktin, do ta riparojnë ose zëvendësojnë Produktin, me vendim të tyre dhe në pajtim me termat dhe kushtet e parashtruara në këtë dokument.

Sony Ericsson dhe partnerët e shërbimit ruajnë të drejtën t'ju kërkojnë të paguani një tarifë trajtimi, në rast se një Produkt i kthyer rezulton të mos ketë qenë nën garanci, në pajtim me kushtet e parashtruara në poshtë.

Kini parasysh se disa nga cilësimet personale, shkarkimet që keni bërë ose të dhëna të tjera mund t'ju humbasin kur Produkti juaj Sony Ericsson t'ju riparohet ose zëvendësohet. Tani për tani, ekziston një mundësi që Sony Ericsson të jetë e penguar me ligj, rregullore të tjera ose pengesa teknike, që të bëjë kopje rezervë të disa shkarkimeve të caktuara. Sony Ericsson nuk mban përgjegjësi për të dhënat e çfarëdo lloji që mund të humbasin, as mund t'ju zhdmtojë për humbje të tilla. Gjithnjë duhet të bëni kopje rezervë të të gjitha të dhënave që ruani në Produktin tuaj Sony Ericsson, të tilla si shkarkime, kalendar dhe kontakte, para se ta dorëzoni Produktin Sony Ericsson për riparim ose zëvendësim.

## Kushtet

- 1 Kjo Garanci e kufizuar ka vlerë vetëm në rast se Produkti për t'ju riparuar ose zëvendësuar shoqërohet nga dëftesa origjinale e blerjes së këtij Produkti, e lëshuar nga një tregtues i autorizuar Sony Ericsson, dhe që përmban datën e blerjes dhe numrin serial\*\* të Produktit. Sony Ericsson ruan të drejtën të refuzojë shërbimin e garancisë në qoftë se këto të dhëna janë fshirë nga fatura, ose janë modifikuar pas blerjes fillestare të Produktit nga tregtari.
  - 2 Në rast se Sony Ericsson e riparon ose e zëvendëson Produktin, riparimi i defektit përkatës ose Produkti i zëvendësuar do të mbulohej nga garancia për periudhën e kohës së mbetur nga kohëzgjatja fillestare e garancisë, ose për nëntëdhjetë (90) ditë nga data e riparimit, cilado nga këto periudha të jetë më e gjatë. Riparimi ose zëvendësimi mund të kryhet nëpërmjet aparatsh të rikushtëzuara, funksionalisht të barasvlershme. Pjesët ose komponentet e zëvendësuarra do të bëhen pronë e Sony Ericsson.
  - 3 Kjo garanci nuk mbulon ndonjë keqfunksionim të Produktit për shkak të vjetërimit normal ose keqpërdorimit, duke përfshirë këtu përdorimin në mënyrë që nuk pajtohet me udhëzimet e Sony Ericsson për përdorimin dhe mirëmbajtjen e Produktit, por jo duke u kufizuar vetëm në këto. Gjithashtu kjo garanci nuk mbulon keqfunksionime të Produktit për shkak aksidentesh, modifikimesh ose përshtatjesh të aparatit ose të programeve që e bëjnë të funksionojë; dëmtime nga një forcë madhore, si dhe nga kontakti me substanca të lëngshme.
- Një bateri e ringarkueshme mund të ngarkohet dhe të shkarkohet me qindra herë. Megjithatë, do të vijë momenti kur të mos funksionojë më – çka nuk duhet konsideruar si defekt i produktit, por vetëm si fazë e procesit normal të vjetërimit. Kur koha e bisedës ose e gatishmërisë vjen duke u shkurtuar ndjeshëm, bateria duhet zëvendësuar.

Sony Ericsson ju rekomandon të përdorni vetëm bateri dhe batingarkues të miratuar nga Sony Ericsson.

Telefona të ndryshëm mund të paraqitin variacione të lehta në shkëlqim dhe ngjyra të ekranit. Në ekran mund të shfaqen njolla të vogla të ndritshme ose të errëta. Këto quhen pikselë të dëmtuar dhe ndodhin kur zona të veçanta të kristalit kanë funksionuar keq dhe nuk mund të ndreqen më. Deri në dy pikselë të dëmtuar konsiderohet e pranueshme. Nga një telefon në tjetrin, edhe imazhi i kameras mund të ndryshojë. Kjo nuk është për t'u shqetësuar, meqë nuk është fjala për ndonjë mangësi të modulit të kameras.

- 4 Meqenëse sistemi celular brenda të cilët do të funksionojë Produkti, ofrohet nga një kompani e pavarur nga Sony Ericsson, Sony Ericsson nuk mban asnjë përgjegjësi për funksionimin, disponueshmërinë, shkallën e mbulimit me sinjal, shërbimet ose rrezet e mbulimit me sinjal të ofruar prej atij sistemi.
- 5 Kjo garanci nuk mbulon keqfunksionime të Produktit të shkaktuara nga montimi, modifikime, riparime ose zëbrithme të Produktit të kryera nga personeli i paaautorizuar prej Sony Ericsson.
- 6 Garancia nuk mbulon keqfunksionime të Produktit shkaktuar nga përdorimi i pajisjeve shtesë ose i pajisjeve të tjera periferike të cilat nuk janë pajisje origjinale të markës Sony Ericsson origjinale të destinuara për përdorim me Produktin.

- 7 Cenimi i vulave të Produktit e shfuqizon garancinë.
- 8 NUK OFROHET ASNJË GARANCI TJETËR E SHPREHUR, ME SHKRIM OSE ME GOJË, PËRVEÇ KËSAJ GARANCIE TË KUFIZUAR TË PARASHTRUAR KËTU. TË GJITHA GARANCITË E NËNKUPTUARA, DUKE PËRFSHIRË PA KUFIZIM GARANCITË E NËNKUPTUARA TË VLERËS TREGTARE, OSE PËRSHTATSHMËRISË PËR NJË QËLLIM TË CAKTUAR, KUFIZOHEN ME KOHËZGJATJEN E KËSAJ GARANCIE TË KUFIZUAR. NË ASNJË RAST SONY ERICSSON OSE LICENSUESIT E SAJ NUK DO TË MBAHEN TË PËRGJEGJSHËM PËR DËME TË RASTËSISHME OSE RRJEDHIMORE TË ÇFARËDOLLOJ NATYRE, DUKE PËRFSHIRË HUMBJET NË FITIME OSE TREGTARE POR PA U KUFIZUAR NË TO, NË ATË MASË TË PLOTË QË ATO HUMBJE MUND SHPËRNJIHEN ME LIGJ. Disa vende/shtete nuk lejojnë përjashtimin ose kufizimin e dëmeve të rastësishme ose rrjedhimore, ose kufizimet në kohëzgjatjen e garancive të nënkuptuara, kështuqë kufizimet ose përjashtimet e përmendura më sipër mund të mos kenë vlerë në rastin tuaj. Garancia e parashtruar më sipër nuk i prek të drejtat statutare të konsumatorëve të parashikuara nga legjislacioni i zbatueshëm në këto raste, as të drejtat e konsumatorit ndaj tregtarit që burojnë nga kontrata e shitblerjes midis tyre.

## \* Shtirija gjeografike e garancisë

Nëse e keni blerë Produktin në një vend anëtar të Zonës Ekonomike Evropiane (EEA), ose në Zvicër a në Republikën e Turqisë, dhe ky Produkt ishte destinuar për t'u shitur në EEA ose në Zvicër a në Turqi, është e drejta juaj ta shpini produktin për riparim në çfarëdo vendi të EEA ose në Zvicër a në Turqi, nën kushtet e garancisë që janë në fuqi në vendin ku kërkoni riparime, me kusht që në atë vend të shitet një Produkt i njëjtë me tuajin, nga një shpërndarës i autorizuar i Sony Ericsson. Për të marrë vesh nëse Produkti juaj shitet në atë vend ku ndodhëni, lidhuni me qendrën vendore të telefonimit Sony Ericsson Call Center. Kini parasysh se disa shërbime mund t'i kryhen Produktit vetëm në vendin ku është blerë origjinalisht; për shembull në vartësi të faktit që Produkti mund të ketë pamje ose përbajtje të ndryshme nga modelet e barasvlershme që shiten në vende të tjera. Kini parasysh edhe se, në ndonjë rast, mund të mos jetë e mundur të riparohen Produkte të kyçur në SIM.

\*\* Në disa vende/rajone mund t'ju kërkohen të dhëna të mëtejshme (si për shembull një kartë e vlefshme garancie).

## FCC Statement

This device complies with Part 15 of the FCC rules. Operation is subject to the following two conditions:

- (1) This device may not cause harmful interference, and
- (2) This device must accept any interference received, including interference that may cause undesired operation.



Any change or modification not expressly approved by Sony Ericsson may void the user's authority to operate the equipment.

This equipment has been tested and found to comply with the limits for a Class B digital device, pursuant to Part 15 of the FCC Rules. These limits are designed to provide reasonable protection against harmful interference in a residential installation. This equipment generates, uses and can radiate radio frequency energy and, if not installed and used in accordance with the instructions, may cause harmful interference to radio communications. However, there is no guarantee that interference will not occur in a particular installation.

If this equipment does cause harmful interference to radio or television reception, which can be determined by turning the equipment off and on, the user is encouraged to try to correct the interference by one or more of the following measures:

- Reorient or relocate the receiving antenna.
- Increase the separation between the equipment and receiver.
- Connect the equipment into an outlet on a circuit different from that to which the receiver is connected.
- Consult the dealer or an experienced radio/TV technician for help.

## Industry Canada Statement

This Class B digital apparatus complies with Canadian ICES-003. Cet appareil numérique de la classe B est conforme à la norme NMB-003 du Canada.

This device complies with RSS-210 of Industry Canada. Operation is subject to the following two conditions: (1) this device may not cause interference, and (2) this device must accept any interference, including interference that may cause undesired operation of the device.

## Declaration of Conformity for T700

We, Sony Ericsson Mobile Communications AB of Nya Vattentorget

SE-221 88 Lund, Sweden

declare under our sole responsibility that our product

**Sony Ericsson type AAD-3052042-BV**

and in combination with our accessories, to which this declaration relates is in conformity with the appropriate standards EN 301 511:V9.0.2, EN 301 489-7:V1.3.1, EN 301 908-1:V2.2.1, EN 301 908-2:V2.2.1, EN 301 489-24:V1.3.1, EN 300 328:V1.7.1, EN 301 489-17:V1.2.1, EN 60 950-1:2006 following the provisions of, Radio Equipment and Telecommunication Terminal Equipment directive 1999/5/EC.

Lund, June 2008

**CE 0682**



---

Shoji Nemoto,

*Head of Product Business Group GSM/UMTS*

Ne përbushim kërkesat e direktivës R&TTE (1999/5/EC).

# Treguesi alfabetik

## A

aktivizoj/çaktivizoj	
funksioni Bluetooth™	26
kyçi i kartës SIM	67
kyçi i telefonit	67
kyçja e tastierës	68
alarmet	60
aplikacionet	66
arkivimi dhe rikthimi	27
audiolibri	20

## B

bateria	
fut	6
ngarkoj	9
blog	
kamera	51
video	51
bllokimi i telefonimit	39
burimet e fotove	56
burimet në Internet	54

## C

cilësimet, për Internet	69
-------------------------	----

## D

data	64
declaration of conformity	83

detyrat	63
devijimi i telefonatës	37

## E

efekti panoramik-zmadhues,	
faqe Interneti	53
emri i telefonit	26
etiketat e fotove	49

## F

faqe Interneti, historia	53
fotot	49
fsheh numrin	40
fut tekst	17

## G

garancia	79
gatishmëria	8
grupet	34

## Gj

gjendja e kujtesës	23, 34
gjuha	16

## H

hartat Google Maps™	60
historia, faqe Interneti	53

<b>I</b>			
Interneti		grupet .....	34
kujtesoret .....	52	kontaktet default .....	31
sigurshmëria dhe certifikatat .....	54	sinkronizimi .....	56
		shtoj kontakte në telefon .....	32
<b>K</b>		kujtesa e kodeve .....	71
kabloja USB .....	25	kujtesoret	
kalendari .....	62–63	krijoj .....	52
kamera .....	47	përzgjedh .....	52
aktivizoj .....	48	kursimi i energjisë .....	27
blog .....	51	kyçja	
cilësimet .....	48	karta SIM .....	66
përdor .....	48	tastiera .....	68
printimi .....	52	telefoni .....	67
shkurtoret .....	48	kyçja e tastierës .....	68
karta e kujtesës .....	16	automatike .....	68
karta SIM		<b>L</b>	
fut .....	6	lista e telefonatave .....	35
kopjoj në/nga .....	33	listat e dëgjimit .....	19
kyçja .....	66	lojërat .....	65
zhbllokoj .....	67	lundrimi në menutë .....	14
kartëvizitat .....	34	<b>M</b>	
kërkimi inteligjent .....	32	menuja e veprimeve .....	15
kërkimi, në faqe Interneti .....	53	mesazheria .....	35
Kodi PIN, ndërroj .....	67	mesazhet	
kohëzgjatja e telefonimit .....	40	figurë .....	42
komandat zanore .....	36	informacioni zonal dhe celular .....	47
komandimi zanor .....	36	posta elektronike .....	44
konferencat .....	38		
kontaktet .....	31, 32		

shkrimore .....	41	PlayNow™ .....	20
zanore .....	43	podkastet .....	56
mesazhet shkrimore .....	41	posta elektronike .....	44
mesazhet zanore .....	43	posta zanore .....	35
mesazhet-figurë .....	42	profilet .....	64
mesazhimi .....	41	profilli Avion .....	59
mikrofondi .....	30	profilli telefon .....	57
MMS <i>Shihni</i> mesazhet-figurë		Programi Media Manager	
modelet .....	43	(Administratori i Mediave) .....	24
montimi .....	6	PUK .....	66, 67
MusicDJ™ .....	22		
muzikë në Internet, dëgjoj .....	21		
<b>N</b>		<b>R</b>	
ndihma .....	8	radioja .....	21
numra të urgjencës .....	30	radioteknologjia Bluetooth™ .....	26
numrat e mi .....	39	regjistrimi, dëgjoj .....	22
Numri IMEI .....	68	regjistruesi zanor .....	22
		ricilësimi bazë .....	69
		riprodhuesi muzikor .....	18, 19
		riprodhuesi video .....	21
<b>O</b>		<b>S</b>	
ora .....	64	sinkronizimi .....	56
orientimi i ekranit .....	65	sistemi pa duar .....	18, 27, 36
		skedari .....	23
<b>P</b>		SMS <i>Shihni</i> mesazhet shkrimore	
pamje e përgjithshme e menuve .....	12	SOS <i>Shihni</i> numra të urgjencës	
PC Suite .....	56		
PE push .....	45		
përgjigjja zanore .....	36		
PhotoDJ™ .....	50		



<b>Sh</b>			
shënimet .....	63	tonet e ziles .....	65
shërbimet e vendndodhjes .....	60	TrackID™ .....	20
shërbimi përditësues .....	59	trajtimi i imazhit	
shkarkoj muzikë .....	20	kamera .....	47
shkurtoret .....	14	videoregjistruesi .....	47
Shokët e mi .....	45	transferim mediash .....	24, 25
		transferoj	
		foto të kameras .....	24
		muzikë .....	24
		tingujt .....	27
<b>T</b>		<b>U</b>	
T9™ Text Input .....	17	udhëzime të sigurisë .....	75
takimet .....	62		
tastet e kameras .....	47	<b>V</b>	
tastet funksionale .....	14	vendndodhja, të dhëna për .....	49
telefonatat		video	
bëj dhe marr telefonata .....	29	blog .....	51
ndërkombëtare .....	29	ndryshoj .....	50
përgjigjem dhe refuzoj .....	30	VideoDJ™ .....	50
pranimi .....	39	videoklipe në Internet, shoh .....	21
regjistroj .....	22	videoregjistruesi .....	47
trajtoj dy telefonata .....	38	volumi	
urgjencë .....	30	mikrofolësi .....	30
vënia në pritje .....	37	toni i ziles .....	65
video .....	31		
telefoni, ndez .....	7	<b>Z</b>	
telefonimi fiks .....	40	zona orare .....	64
telefonimi i shpejtë .....	35	zoom .....	48
telefonoj numrave në një mesazh .....	41		
tema .....	64		
tone zillesh specifike për telefonuesit ...	32		